



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik
Kuvendi i Komunës
-Kryesuesi i Kuvendit-

01Nr. 60/01-7034/24
Kaçanik, 20.03.2024

FTESË PËR MBLEDHJE

Të nderuar Anëtarë të Kuvendit të Komunës,

Në bazë të nenit 43 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, e thërras mbledhjen e III (tretë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2024.

Mbledhja do të mbahet në sallën e kuvendit të komunës, në katin e tretë të objektit të komunës, me 29 mars 2024 (e Premte) në ora 11:00.

Mbledhjen do ta kryeson dhe udhëheq Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit.

Ju mirëpresim!

Me respekt!

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli

Në mbledhjen e III (tretë) të Kuvendit të Komunës të datës 29.03.2024 do të shqyrtohet ky:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Draft Statuti i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare;
3. Propozim Vendimi për aktivizimin e pagesave në QKMF në Komunën e Kaçanikut;
4. Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në atë ndërtimore, Zona Kadastrale Ivajë, në emër të Samedin Rexha;
5. Propozim Vendim për shpallje me interes publik të Parcelave kadastrale në Zona Kadastrale Kaçanik dhe Gajre;
6. Propozim Vendim për Subvencionim të fermerëve;
7. Raport periodik për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit, të vitit 2022;
8. Raporti i punës i Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2023.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal of Kacanik

01Nr. 60/01-4683/24
Kaçanik, 29.02.2024

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **II (dytë)** e rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2024 (Legjislatura e shtatë), mbajtur me 29 shkurt 2024, në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës prej 27 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje 26, mungoj me arsye Edon Baftiu.

Nga Ekzekutivit i Komunës, në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, Nënkryetari i Komunës- Sabedin Vishi, Drejtorët e drejtorive: Bahri Selimi-DBF, Ramadush Osmani-DSHPE, Qamil Stagova- DUKMM, Suhad Dullovi- DBPZHR, Zahir Doda- DA, Pranvera Loku-Zharku-DZHET, Dardana Tafili-Dauti-DAP, Hafize Sallahi-DKRS, Sali Malsiu-DSHMS, ndërkaq nga zyrtarët e komunës në kuadër të detyrave të punës ishin: Hidajete Guri, Bejtulla Dalloshi, Mavije Murseli, pati edhe zyrtar tjerë të komunës.

Nga strukturat vendore mbledhja monitorohet përmes Teleprezencës nga Vjosa Ahmetaj-zyrtare në MAPL. Mbledhja ka transmetim të drejtpërdrejtë.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Murseli- Kryesues i Kuvendit
Procesmbajtës, Makfire Malsiu.

Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Murseli: Të nderuar pjesëmarrës, së pari iu përshëndes të gjithëve, iu dëshiroj mirëseardhje, konstatoj kuorumin duke i thirrur emër, kushte pune me u mbajt mbledhja ka, e hapi mbledhjen e II (dytë) të rregullt të Kuvendit të Komunës për vitin 2024, data 29 shkurt, me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Raporti Vjetor i Ekzekutivit të Komunës për vitin 2023;
3. Raporti Vjetor Financiar për periudhën, Janar – Dhjetor 2023;
4. Informatë për përfundimin e Gjysmë vjetorit të Parë të vitit shkollor 2023/2024 ;
5. Informatë e menaxhimit të burimeve njerëzore për periudhën Janar – Dhjetor 2023;
6. Raporti vjetor lidhur me auditimet e brendshme të kryera dhe aktivitetet e Auditimit të Brendshëm për vitin 2023;
7. Propozim Vendim Paraprak Për Dhënien e Pronës së Paluajtshme të Komunës në Shfrytëzim Afatgjatë për 99 vite;
8. Propozim Vendim Për Formimin e Komisionit Vlerësues Për Dhënien në Shfrytëzim Afatgjatë Për 99 vite të Pronës së Paluajtshme të Komunës;
9. Propozim Vendim Paraprak Për Dhënien e Pronës së Paluajtshme të Komunës në Shfrytëzim Afatshkurtër për 15 vite;
10. Propozim Vendim Për Formimin e Komisionit Vlerësues Për Dhënien në Shfrytëzim Afatshkurtër të Pronës së Paluajtshme të Komunës;
11. Plani i Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2024;
12. Kërkesa e MAPL për Rishqyrtimin e Vendimit 01 Nr.06-104/02-1940/24 për miratim në parim të Vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, me pronën e paluajtshme të personit fizik Mejdi (Shabi) Khokli;

13. Kërkesa e MAPL për Rishqyrtimin e Vendimit 01 Nr.06-104/02-1934/24 për miratim në parim të Vendimit për këmbimin e pronës së paluajjtshme të komunës, me pronën e paluajjtshme të personit fizik Adnan (Feriz) Vishi;
14. Kërkesa e MAPL për Rishqyrtimin e Vendimit 01 Nr.06-104/02-1938/24 për miratim në parim të Vendimit për këmbimin e pronës së paluajjtshme të komunës, me pronën e paluajjtshme të personit fizik Ramiz (Afiz) Shaqiri.
15. Diskutim për Planit Zhvillimor Komunal-PZHK.

Pika 15 ka hyrë në rend pune me propozim e Ardita Rrahmani, e cila në emër të GP të LDK e cila kërkoj të futet në diskutim PZHK, ndërkaq e kishte iniciuar edhe në KPF.

Kryesuesi i Kuvendit: Kërkoj të hynë në rend pune pika e 15, çështje kjo e ngritur edhe në KPF. Drejtori është i njoftuar për me qenë i përgatitur për këtë pikë.

z. Agim Mani: Meqë nuk kemi pas koordinim paraprak dhe rendi i punës është shumë i ngjeshur, ne jemi të procedojmë vetëm me pikat sipas ftesës për mbledhje, 1-14. PZHK me debatuar na merr kohë, kjo çështje është e nevojshme të debatohet në një mbledhje vetëm të KK si pikë e vetme.

znj. Ardita Rrahmani: Ne kemi qenë pjesëmarrës dhe i kemi kontribuar debatit në KPF. Është e drejtë e secilit a është për apo kundër, ndërkaq pavarësisht sa zgjatë mbledhja, ne jemi këtu për t'i kontribuar debatit. Nëse e shtyjmë këtë pikë për një mbledhje tjetër, arsyet duhet me i thënë këtu me saktë, se për kundër që është shtyrë për 4 vite PZHK, jemi duke e shtyrë edhe për 1 muaj për shkakun e juaj.

z. Adnan Reka: Mbi çfarë baze do të diskutojmë PZHK Ardita, kur nuk kemi material. Nëse është dashur me diskutuar për PZHK, paraprakisht është dashur me futur ne rend pune dhe me pasur materialin, pavarësisht çfarë kritikash keni dhe a janë të qëndrueshme ato kritika.

Kryesuesi i Kuvendit: Kjo çështje është iniciuar edhe në KPF, është kërkesë me u futur ne rend pune diskutimi i PZHK, kjo ka me qenë informatë, nuk ka me u votuar dhe nuk besoj se na merr shumë kohë diskutimi i PZHK. Për mua propozimi është i arsyeshëm me u diskutuar, a kalon apo jo është çështje tjetër.

z. Adnan Reka: Nëse është ashtu, është dashur të ngritet si pyetje në KK, përgjigjen e jep drejtorja, se ne nuk mundem me diskutuar këtë PZHK pa material.

z. Rustem Zenuni: Kërkesa e ngritur edhe pse është me vonesë, ne PDK mendojmë se është mirë të jetë në rend pune, ndërkaq po të kishte materialin, do të ishte me mirë.

znj. Ardita Rrahmani: Për mungesë të informatës, unë po kërkoj diskutim për çështjen e PZHK. Drejtori përgjegjës na sqaron se ku ka arrit çështja e PZHK?

z. Agim Çaka: Propozimi me u futur në rend pune kjo pikë, është brenda rregullores dhe duhet me dal në votim, ndërkaq anëtarët e KK duhet me pasur materialin. Se ku ka ngelë çështja e PZHK, kemi bërë pyetje në vazhdimësi në mbledhje të KK. Propozimi për diskutim të PZHK duhet të shtrohet në votim, nëse kalon, hynë në rend pune.

z. Naim Beça: Nëse është kërkesë e opozitës, pse nuk e mbajmë një mbledhje të KK me diskutuar vetëm çështjen e PZHK? Ne si opozitë mund të kërkojmë tani me u shtuar edhe 20 pikë tjera dhe me mbetur gjatë në mbledhje të KK. Ne nuk jemi të papërgatitur për këtë pikë dhe nuk mundem me dhënë kurrfarë kontributi.

z. Agim Mani: Ne jemi për miratimin e rendit të ditës me pikat sipas ftesës për mbledhje.

Kryesuesi i Kuvendit: Për drejtorin është me mirë me u larguar kjo pikë, se përgatitet për ndonjë mbledhje tjetër, por miratimin e kemi marrë në KPF me u diskutuar PZHK. PZHK ka me u miratuar kur të vjen materiali në KK, sot do të diskutohet se ku ka ngelë çështja e tij. Kërkesën e Ardites e shtroj në votim për aprovim. Për votuan shumica. Kundër 8 anëtarë nga

LVV. Abstenim nuk ka. Në saje të rezultatit të votimit, del konstatimi se, Kërkesa për diskutim të PZHK, futet në rendin e punës. Atëherë, Rendin e punës me shtimin e pikës 15 e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës,

APROVOJ

Rendin e punës në përbërje prej 15 pikave.

U kalua në shqyrtimin e pikëve sipas renditjes:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;

Procesverbali i mbledhjes se kaluar u aprovua me shumicën e votave Për, Kundër votë s'ka. Abstenim nuk ka, ndërkaq 8 anëtarë nga LVV nuk morën pjesë në votim, 7 prej tyre nuk kanë qenë pjesë e mbledhjes se kaluar, për shkak se i kanë bojkotuar punimet e mbledhjes. Në saje të kësaj del konstatimi se KK,

APROVOJ

Procesverbalin e mbledhjes së I (parë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës Kaçanik të datës 31.01.2024 / Lënda: 01Nr. 60/01-2329/24.

Pyetje dhe Kërkesa

znj. Kadrije Lika-Troni: 1. Kërkoj nga DSHMS të merr iniciativë për zgjerimin e kapaciteteve të shërbimeve laboratorike, pasi kanë kaluar ankesa të ndryshme lidhur me organizimin e këtyre shërbimeve. Unë mendoj se duhet të eliminohet mënyra e ofrimit të shërbimeve laboratorike me termin, ku qytetarët detyrohen të vijnë 2 ditë radhazi për shërbime laboratorike, 1 ditë për termin, e ditën tjetër për me kryer analiza. Shëndeti i qytetarëve tonë duhet të jetë çështje primare dhe përgjegjësi e gjithë neve, andaj kërkoj t'i jepni përkrahje kërkesës time.

2. Pyetja 2 është për DUKMM, Në f. Kovaçec, rruga: “Mynir Thaqi” që lidhë rrugë:” Hamzë Jashari” me rrugën e “UÇK-së” e cila kalon mbi urën e lumit Lepenc në Kovaçec, kësaj rruge i mungon ndriçimi publik dhe trotuari. Kjo rrugë është shumë e frekuentuar nga banorët, ka rrezik permanent për këmbësorët. Kërkoj nga drejtoritë përkatëse të marrin veprime të duhura për këtë kërkesë.

z. Adnan Reka: Pyetja është për Kryetarin e Komunës: Çfarë keni bërë konkretisht, apo cilët janë hapat ligjor apo administrativ që keni marrë pas konstatimit të komisionit komunal për mbikëqyrje dhe realizim të kontratave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave komunale, se Mevlud Zharku si palë kontraktuese ka shpërfillur kontratën dhe ligjin në lidhje me pronat shoqërore të komunës në sipërfaqe me tepër se 2.5 hektarë ? I rikujtojmë disa nga shkeljet ligjore që janë konstatuar: Ka bërë ndryshimin e pronarit, nuk ka respektuar planin dinamik, nuk ka respektuar planin e biznesit, ka ndërtuar objekte pa leje dhe shumë shkelje tjera.

z. Naim Beça: Kam 2 kërkesa dhe 1 pyetje: 1. Është hera e 5-6 që kam ngritur çështjen për ndriçimin e rrugës “Sali Bajra”. Pse nuk bëhet ndriçimi publik i kësaj rruge? Njëherë e kam përmendur se është rrezik permanent për fëmijët që vijën nga shkolla, se është rrugë një kahe dhe qentë endacak në qytet janë shtuar shumë, por nuk u rregullua ndriçimi publik në atë rrugë. Pronarët e lokaleve përgjatë asaj rruge janë ankuar për çështjen e rrezikimit të lokaleve të tyre, se janë 10 lokale. Kërkoj të rregullohet ndriçimi në atë rrugë, se rruga është shumë e qarkullueshme, mungesa e ndriçimit publik paraqet rrezik permanent.

2. Çështja e kubzave, u bë një lloj tragjedi- komedie, e keni parë edhe vet se keni kaluar atypari. Duhet me u rregulluar mirë kubzat njëherë e përgjithmonë, e jo çdo muaj me intervenuar.

3. Bllokimi i korzës të Bulevardi: “Ismail Raka”, aty ku është ndërtuar ura, u bllokuar me hekura. Duhet me kërkuar nga kompania me liruar rrugën, se nuk është duke punuar aty, se ka pasur raste kur janë lënduar fëmijët duke kaluar atypari.

4. Pyetje për të gjitha drejtoritë: Është edhe shqetësim i qytetarëve: Sa projekte kanë filluar në Kaçanik dhe nuk kanë përfunduar, arsyeja pse pse nuk janë përfunduar, se kemi shumë projekte në Kaçanik që kanë filluar e nuk kanë përfunduar?

z. Agim Çaka: Pyetje ime e parë është e njëjtë me atë që e ngriti Naimi. Çështja e kubzave, mendoj se është sanim i përkohshëm. Kur mendohet të bëhet një zgjidhje e përhershme, se kjo gjendje po na përcjellë nga periudha e pasluftës? Ku është problemi, a nuk kemi ekspertë që mundën me sanuar, pse po ndodhin defektet, sidomos të kalimi i urës dhe në hyrje kah Çarshia e qytetit. A është një problem që nuk ka zgjidhje, apo ka zgjidhje, por nuk dimë me bërë zgjidhje? Për këtë çështje mendoj se nuk ka kohë me prituri dhe është e tepër me diskutuar në seanca të KK.

2. Pjesa mbi hallën e sporteve, ka një pamje të keqe, me çka e humbë pamjen e bukur të hallës së sporteve. Është një muri i bllokave që nuk ka kurrfarë funksioni, pastaj shkallët e betonit që janë jashtë funksionit. A keni menduar për largimin e tyre? Ajo pjesë mundet me u shfrytëzuar për mbjellje të drunjtëve dekorativ, gjelbërim, me i dhënë pamje të mirë magjistrales dhe hallës sportive.

3. Po e ngriti një shqetësim të banorëve të lagjes Koxhaj për mungesën e ujit të pijes në shumicën e kohës. Në një mbledhje e kam bërë një pyetje, sepse aty është bërë një shpim për një pompë, përmes se cilës uji bartet dhe kalon në Sepetin në rezervuarin kryesor, dhe pastaj bien me rënie të lirë. A është funksional ky projekt, a është duke kryer funksionin për çka është bërë investimi?

z. Ekrem Livoreka: 1. Kërkesa e parë është për DSHPE. Në Lagjen Çardak, ndriçimi publik nuk funksionon që 3-4 muaj. Ku qëndron problemi, kur dihet se ndriçimi publik ka funksionuar pothuajse vetëm 1 muaj?

2. Kërkesa e dytë është për DBF: Me kërkesë të disa administratorëve të zonave dhe fshatrave, po e ngriti çështjen e kompensimeve të tyre, sepse nuk janë paguar për aktivitetin e tyre. Ne si komision kur janë zgjedhur administratorët, jemi deklaruar se do t'iu paguhet një shumë simbolike, por sa po e shoh unë, kjo nuk është realizuar.

z. Betim Shala: I kam 2 kërkesa të cilat i kam ngritur edhe me herët: 1. Ndërtimi dhe ri rregullimi i rrugës: “Skënderbeu”, pasi u rregulluar hekurudha aty është mirë me u rregulluar, se kemi me mbetur edhe pa parking edhe pa trotuar.

2. Ndërtimi i kanalizimit dhe rrugës, në rrugën: “Sylejman Kuka” çështje kjo e ngritur për disa herë. Ajo rrugë nuk i ka as 100metra, ndërkaq nuk mundesh me qëndruar aty prej kanalizimit. Është mirë me futur këtë projekt të projektet, Ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrugëve lokale.

Kryesuesi i Kuvendit: Përgjigjet i jep ekzekutivi i komunës. Kalojmë në pikën vijuese:

2. Raporti Vjetor i Ekzekutivit të Komunës për vitin 2023;

Është dokument voluminoz që paraqet aktivitetin e ekzekutivit të komunës. E hapi diskutimin.

z. Brahim Imishti: E vlerësoj si vit me dinamizëm të theksuar, të shumë sektorëve. Kjo shkon si rezultat i punës së kryetarit, nënkryetarit, drejtorëve dhe gjithë stafit tjetër të komunës. Unë shpresoj dhe besoj se viti 2024 do të jetë një vit edhe me i suksesshëm në shërbim të qytetarëve të komunës së Kaçanikut.

z. Agim Mani: Raporti është voluminoz dhe na merr me shumë kohë, por është e rëndësishme të elaborohet, po bëjë një përmbledhje të raportit. Raporti i paraprinë planit të ekzekutivit të vitit 2023. Nëse e krahasojmë planin e ekzekutivit me këtë raport, ka një diskrepancë të madhe, sepse vizioni, qëllimi, misioni kanë qenë diçka tjetër, realizimi tregon diçka tjetër. Po lidhem të fjala e kryetarit, që ka thënë se ky vit ishte sfidues jo vetëm për ne, por ishte një sfidë që ndikon në funksionimin e komunës për shkak të inflacionit dhe mungesa e përkrahjes buxhetore nga niveli qendror. Nuk është mirë sa herë të akuzohet niveli qendror, përderisa nuk e

shpenzoni buxhetin komunal. Janë mbi 1 milion euro të pashpenzuara, fillimisht duhet të shpenzohen këto mjete, pastaj të kërkohet buxhet nga niveli qendror. Mirë është me kërkuar mjete, por duhet edhe me shkuar fizikisht, të dërgoni projekte në ministri, dhe në takim me kryeministrin me kryetarët e komunave, të kërkoni realizimin e projekteve, e jo t'i injoroni takimet me kryeministrin, se nuk merrni pjesë me i paraqitur kërkesat e juaja, që me pasur përkrahjen e kryeministrit. Pyetje: Sa projekte i keni dërguar në këtë vit, që bënë thirrje ministri i infrastrukturës? Të DAP, numri i lëndëve të realizuara, 34.626 lëndë të kryera, kjo është sqaruar në KPF, duhet sqarohet edhe në KK, ndërsa te të hyrat tregon diçka tjetër. Të DSHMS, është për me u përshëndetur zvogëlimi i rasteve sociale që gëzojnë të drejtën e asistencës sociale, uroj të ketë sa me pak rastet të tilla. Numri i shërbimeve shëndetësore 346,630 shërbime, duke pasur parasysh edhe mjekësinë private, ndërkaq komuna nuk ka subvencionuar shërbimet shëndetësore, bazuar në vendimin për pandeminë, edhe pse atij vendimi iu ka skaduar afati. DSHPE, kjo drejtori duhet t'i raportoj qytetarëve për kryerjen e shërbimeve. Kjo drejtori ka menaxhuar shumë projekte infrastrukturore, ndërkaq nuk ka pasur plan për projekte. Në f. Ivajë ka investuar në ujësjellës 6 km thuhet në fazën e dytë, projektet këtu janë të vonuara, sepse fshati 70% është braktisur. Ndriçimi publik, është investuar në 5134m apo 158copë të mbulueshmerisë ndriçimit publik, qytetarët përballën me mirëmbajtjen e ndriçimit publik, kam pyetje parashtruar për këtë çështje para 7-8 muajve, përgjigje nuk kam marrë. Të parkingjet publike, është e pakuptimtë si ka vepruar ekzekutivi, njëherë ia ka marrë shoqatës të invalidëve të luftës së UÇK, ne kemi qenë kundër atëherë, se nuk ka qenë në rregull me iu marrë dhe me iu dhënë "Pastërtisë", iu ka dhënë në këmbim, por nuk ka funksionuar, pastaj ia keni dhe kompanisë private, por nuk ka funksionuar. Dhe jeni detyruar me u kthyer në gjendjen e mëparshme. Të menaxhimi i mbeturinave, kërkohet përgjigjen e drejtorit: Sa deponi ilegale janë pastrua gjatë vitit dhe kostoja. Të mirëmbajtja e rrugëve dimërore, kontrata ka qenë e përafërt me asfaltimin e rrugëve, edhe pse nuk ka pasur borë, kontrata është nga mallrat dhe shërbimet, ndërkaq me kontratë është shtuar asfalt, ndërtohet mure. DUKMM, kjo drejtori menaxhon me shumë projekte urbanistike dhe me së shumti atakohet me PZHK. PZHK i ka skaduar afati që sa vite, ndërsa ju si ekzekutiv e keni neglizhuar këtë plan dhe nuk keni arritur me sjellë në KK Në mungesë të PZHK shpesh po shfrytëzohet KK në marrjen e vendimeve në sh përputhje me legjislacionin në fuqi. Kjo drejtori ka menaxhuar projekte të rregullim dhe asfaltimit të rrugëve urbane dhe rurale, ndërkaq nuk janë publikuar rrugët që kanë me u shtruar, të cilat kanë kaluar procedurën e prokurimit, publikimi është bërë pasi janë shtruar rrugët, se nuk e ka ditur se cilat rrugë do të shtrohen, se kemi bërë pyetje edhe në KK, nuk kemi marrë përgjigje. Kjo nënkupton se ka pasur diskriminim të asfaltimit dhe rregullimit të rrugëve urbane dhe rurale, se janë asfaltuar rrugët nga janë militantët e partisë, janë shtruar rrugët 60m të 2 shtëpive, jo ato që kanë 10 shtëpi me 300m. DBZHRP, është mirë në këto raporte të paraqitet gjendja reale e bujqësisë për qytetarët, të jenë statistikat për mbjellje pranverore dhe vjeshtore, të misrit dhe grurit, të jetë një pasqyrë e përgjithshme, përfshirë edhe fermerët e vegjël që nuk e gëzojnë të drejtën e subvencioneve, sipërfaqja e të mbjella, numri i bagëtive. Shpresoj që subvencionet të jenë shkuar në vendin e duhur, rritjen e subvencioneve nga niveli qendror dhe lokal. Participimi i fermerëve që kanë përfituar subvencione, 20% ka qenë i lartë, përkrahja nga OJQ Relief, ka qenë 60%, komuna 20%, aq sa ka qenë participimi i fermerëve. Kjo drejtori nuk ka qenë serioz në ruajtjen e tokave bujqësore, se paku nuk është ngritur asnjë shqetësim në këtë drejtim. Janë mbi 3 ha që janë shndërruar në tokë ndërtimore, pyjet doni me i shndërruar në tokë bujqësore, sepse nuk po merren masa për prerjen e drunjtëve. DZHET, kjo drejtori ka një rëndësi të veçantë në zhvillimin ekonomik dhe turizmit, duhet përkushtim, profesionalizëm, e që në bazë të këtij raporti, nuk i posedon këto. Profesionalizmi është zero. Zhvillimi ekonomik i një komune bazohet në strategji afatgjate, plane zhvillimore, por nuk jeni bazuar në këto baza, e jo duke u marrë me ndriçim, çiklizëm, sepse infrastruktura ju takon drejtorive tjera. Komuna ka kuadro të shumta profesionale, por ekzekutivi nuk po i shfrytëzon këta mekanizma. Në raportin e DZHET është publikuar edhe lista e pronave komunale që epën në shfrytëzim, ndërkaq nuk ka raport për pronat që janë dhënë me herët, që të jetë pasqyrë reale e zhvillimit ekonomik e komunës tonë. Mos koordinimi i kësaj drejtorie me nivelin qendror dhe lokal, është bërë si

rutinë të akuzohet ministria, pa pasur projekte. E kritikoni ministrinë se nuk iu ka përkrahur në projektet: Asfaltimin e rrugës për Luboten, Ndërtimin e projektit të kolektorit për ujërat e zeza të Gërllicë- Guri i shpëmë etj. Këto projekte nuk janë përkrahur nga ekzekutivi, sepse projekti i asfaltimit të rrugës për Luboten, nuk është në plan të ekzekutivit, nuk ka projekt e as kod buxhetor, por vetëm kritikë të ekzekutivit në ministri, pa dorëzuar projekt në ministri. Ndoshta mendoni në këtë formë t'i zhgënjëni qytetarët për mospërkrahje të qeverisë Kurti. Qytetarët janë duke na përcjellë dhe po iu themi qartë që këto ankesa që i keni në qeveri, ju nuk keni as projekte ideore, dhe nuk keni dorëzuar projekt në qeveri. Këtë pyetje ia kam bërë kryetarit, përgjigja ka qenë se nuk kemi projekte të tilla. Nëse kryetari ka projekt për rrugën në Luboten, mund të përgjigjet tani për projektin dhe koston. Të DKRS, me tepër paraqet planin vjetor sesa raport, ka paraqitur realizimin e aktiviteteve të projekteve, por nuk ka përfshirë të gjitha aktiviteteve, sepse nuk ka pasur plan të aktiviteteve. Nuk ka përkrahur festivalin e valleve, këngëve dhe lojërave të ndryshme tradicionale, as me prezencën e tyre në këtë festival, vetëm se ka qenë organizim i ministrisë. Nuk është paraparë në plan të aktiviteteve, shpallja e 7 shtatorit të Kushtetutës së Kosovës, datë kjo shumë e rëndësishme. 107 projekte thuhet se janë kontraktuar në Zyrën e prokurimit, një pjesë e tyre me aneks kontrata. Këtë e diskutojmë edhe të plani financiar. Projekte që i bëni, duhet me qenë të detajuara, e jo çdo projekt të ketë aneks edhe pse lejohen me ligj, por duhet të aplikohen vetëm në raste specifike.

znj. Kadrije Lika-Troni: Po fokusohem të Drejtoria e Arsimit-DA. Gjatë vitit 2023 ka pasur nxënës që kanë treguar suksese të jashtëzakonshme në fushat ekzakte në gara të nivelit ndërkombëtar Kangaro që i organizon Atomi dhe në garat shtetërore, në lëndën e fizikës. Selman Bela, çmimin e parë në garat shtetërore në lëndën e fizikës, Erodit Jakupi, në gara e Atomit, nga zënë vendin e parë nga 36 me të mirëve nga 2500 pjesëmarrës. A janë ftuar drejtor apo a ka ndarë ndonjë çmim DA, apo mirënjohje për këta nxënës. Kryetar edhe ju nuk keni pasur ndonjë reflektim për këtë sukses të nxënësve, nuk është bërë asnjë postim në faqe të komunës për këto arritje të nxënësve të komunës, për të paraqitur dhe promovuar suksesin e tyre.

z. Agim Çaka: Raporti është një prej pikave shumë me rëndësi, pasqyron punën njëvjeçare të ekzekutivit për vitin 2023, materiali është shumë i gjerë, nëse e shikojmë dhe e analizojmë në detaje, na merr shumë kohë. Nëse në raport thuhet se është punuar shumë, kjo duhet të jetë në proporcion të drejtë me punën në praktikë. Jemi ndër komunat me pak të zhvilluar, me infrastrukturë jo të mirë, pa PZHK dhe hartat Zonale, me biznese me qarkullim me të dobët, turizmin minimal zero, me resurset që i kemi, shpenzimin e parasë mbi 50% jashtë komunës në tregti dhe shërbime, kapacitetin e të rinjve është në minimum, rezultatet në arsim jo të kënaqshme, probleme në ofrimin e shërbimeve shëndetësore, ka disa mungesa elementare, mungon në QKMF terapia antishok. Inspektorati ka të drejtë me mbyllë ordinancën qoftë private apo shtetërore nëse nuk ka antishok terapi, nuk guxon institucioni me funksionuar. Si rezultat i këtyre çështjeve, ne po shohim largimin e qytetarëve nga komuna jonë. Të shërbimet e ofruara, numri i përgjithshëm është 33508 lëndë, ndërsa të përfunduara janë 18102 lëndë të shtylla e fundit në raportin e DAP, kurse të drejtoritë tjera, të DA është zero. Çka është në pyetje, mos është gabim këtu? Nëse totali është 18102 lëndë, atëherë na dalin shifra tjera. Nëse bëhen gabime në tabela, atëherë shifrat bien poshtë. Të regjistrimi i lindjeve, nuk e kuptoj çka janë lindjet e veçanta, lindjet e rregullta, çka janë kurorëzimet speciale, janë 89 regjistrime, pastaj regjistrimet e vdekjeve të rregullta, regjistrime të vdekjeve speciale, cili është kuptimi i këtyre regjistrimeve. Për secilën drejtori kam vërejtjet e mija për mos punë, ndërlihur me atë që e theksova në fillim.

z. Adnan Reka: Raporti shfaq nivelin e dobët të qeverisjes, si në dukje dhe përmbajtje. Në dukje, se teknikisht nuk i plotëson kriteret minimale si raport i ekzekutivit, asnjë fletë nuk është e vendosur drejtë horizontalisht apo vertikalisht, nuk përmban numrin e faqeve, etj. që e bëjnë të vështirë leximin e tij dhe shmangie të transparencës, e pasaktësi si e potencoj edhe Agim Çaka. Në përmbajtje, ka informata të pasakta dhe të pavërteta. Në vitin e kaluar pati shumë

sh përputhje në mes raportit të ekzekutivit dhe raportit financiar të shpenzimit të parasë publike. Tani është me keq, nga pamundësia për t'i harmonizuar shumat e shpenzimeve, shumica e drejtorive nuk i kanë publikuar shpenzimet fare. Në njërin anë ka informata të tepërta raporti, në anën tjetër mungojnë informatat kryesore apo janë të pasakta. Si mund të besojmë një raport të pasaktë dhe të pavërtetë, si mund të jetë një raport transparent dhe llogaridhënës dhe profesional. Për parkingun nëntokësor, të fjala e kryetarit, paragrafi 2, kemi mungesën e përkrahjes nga niveli qendror. Kjo është e pavërtetë për mua. Komuna nuk ka ngecë për shkak të përkrahjes nga niveli qendror, por për shkak të paaftësisë për t'i menaxhuar dhe realizuar investimet nga niveli qendror. Ja disa fakte ndër vite, jo vetëm nga qeveria Kurti. Në vitin 2017, ndërtimi i kompleksit banesor, procedurat tenderuese janë udhëheq nga komuna, vlera e projektit mbi 300 mijë euro, shuma ka kaluar mbi 600 mijë euro dhe projekti nuk ka përfunduar ende. Në vitin 2019 Ndërtimi i stadiumit në Kaçanik-faza I-r, e financuar nga MKRS, vlera 770,343€, procedurat janë udhëheqë nga komuna, projekti nuk ka përfunduar as pas rekomandimeve të ministrit Çeku. Në vitin 2022, humbja e grantit MAPL, në vlerë 236,000€ për rrugën: Gërlicë, Kaçanik i Vjetër, Stagovë- Runjevë, procedurat e udhëhequra nga komuna, projekti ka dështuar si rezultat i procedurave të prokurimit. Se fundi kemi thirrje për projekte të përballueshme për komuna, pyetja është: A keni aplikuar për këto projekte, apo thirrja tjetër për projekte për bashkëfinancim me komuna, 17 milion i ka ndarë qeveria. A keni aplikuar për ndonjë projekt, marrë parasysh edhe para masën dhe parallogaritë e jo projekte në formë dëshirore, pa ofruar projekt, komuna ka ngelë si rezultat i paaftësisë apo keqpërdorimeve të projekteve, fondeve nga niveli lokal, komuna jonë ka mungesë të investimeve të reja. Kritikat për IK nuk duhet t'i adresohen qeverisë, por kryetarit dhe ekzekutivit, sepse në njërin anë kemi të shpenzuara 440,000€ për parkingun nëntokësor, parkingu nuk është realizuar. Shpronësimi i një lokali të gjimnazi Skënderbeu, 1 ari i kushton komunës mbi 500 mijë euro. Këto dy projekte i kushtojnë komunës mbi 1 milion euro, prandaj problemi është këtu e jo të niveli qendror.

Nënkryetari i Komunës-Sabedin Vishi: E vlerësoj interpretimin e secilit në raportin e ekzekutivit që është voluminoz, por është puna 1 vjeçare, jam kundër kritikave pavend. Po filloj me mungesën e përkrahjes së nivelit qendror, që po bëni pyetje të kryetari pse nuk ka projekte nga niveli qendror. Është e vërtetë se nuk kemi përkrahje që 3 vjet nga niveli qendror, në takimet me kryeministrin ka marrë pjesë si komunë në 50% të takimeve. Janë që 3 vjet të qeverisjes që ka 50% të votave, i kemi projektet, këtë po e bëjë për hir të qytetarëve, janë projektet të cilat i kemi dërguar në formë të detajuar në ministri, janë kodet, por nuk kemi hasur mirëkuptim për mbështetje financiare. Projekti i vetëm i mbështetur që kemi nënshkruar memorandum të mirëkuptimit, është nga ministri për komunitete Fikrim Damka në vlerë 60.000€, këto janë nga gjitha aplikimet tona në gjitha ministrinë, jo për neglizhencën tonë, por nuk kanë dashur me investuar në komunën tonë. Projekti që financohet komplet nga ministria, është shkolla në Doganaj, kontrata në vitin 2019, është dashur me përfunduar për 3 vite, çka është me e keqja që atje ka insekte, bijën krimbat në banka, ministri as email nuk na ka kthyer. Krejt kjo punë është bërë shumë e madhe edhe nga qytetarët, organet relevante nuk e ka marrë parasysh, kjo nuk është për neglizhencën tonë, por të ministrisë, se nuk e kanë pa të arsyeshme me investuar këtu. Raporti mund të ketë gabime, mund të çalohet në projekte, por të thuhet se gjithçka është keq, çdo kontratë që është lidhur është e papërfunduar, është e pavërtetë. Askush nuk e theksoj, ndërtimin e QKMF që është me e menaxhimi në Kosovë, nuk e përmend, pajisja me gjinekolog, pomolog, radiolog, orari barnatoreve është rregulluar, që ishte shqetësim i mëhershëm, është bërë objekti për persona me aftësi të kufizuara. Të PZHK është pikë e veçantë, nuk po përgjigjem. Të emërtimi i rrugëve, rrugët janë krejt me emra, ku ka pasur me u investuar, gjë që është e pavërtetë ajo që e theksuat. U thanë se është investuar në rrugët nga është partia në pushtet, kjo nuk është e vërtetë, është rruga: “Ag Apoloni” rruga: “Emsale Frangu”, janë shumë projekte në zona urbane dhe rurale, ka projekt të realizuar nga vjen deputeti nga partia e juaj, e kjo po bien ndeshë me atë që e thoni. Të DBPZHR, subvencionet në program të kryetarit dhe drejtorive, janë tejkaluar për 1 vit, që është për 4 vite, është mirë me ditur edhe qytetarët se mbledhja është drejtpërdrejtë, dhe po shfrytëzohet edhe për poen

politik. Të DZHET, potenciali kryesor është turizmi. A kemi bërë mjaftueshëm në turizëm, jo, ia kemi nisur, janë shkallët të guri i shpëmë, parku në Strazhë, kulla të dy lumenjtë. Janë dhënë në këtë vit prona në shfrytëzim, duhet shikuar a janë kompanitë serioze apo jo. Sistemi aktual i zhvillimit ekonomik, është ekonomia e tregut. Komuna nuk hap fabrika, komuna jep prona në shfrytëzim dhe rregullimin e infrastrukturës për ato prona. Pronat janë bërë publike, komisionet janë nga KK, Ekzekutivi dhe OJQ, ata na rekomandojnë për ata që i plotësojnë kushtet me marrë pronë në shfrytëzim. Të arsimit, nuk e përmendi askush që SHMP po mundohemi me i dhënë qasje tjetër me ndryshe, pastaj pajisja e disa shkollave me halla të kulturës fizike. Takimin e parë me ministrin e kam pasur për ndërtimin e shkollës “Emin Duraku”, projekti kushton mbi 3 milion euro, nuk mundemi me mbuluar ne, kështu ju bëjë thirrje t ‘na ndihmoni edhe ju të nxjerrim këtë projekt, se është në të mirën e nxënësve dhe qytetarëve. Transporti i nxënësve nga viset rurale është bërë, dhe duhet gëzuar këtij suksesi. Të DKRS, ë keni pa që subvencionohen klubet dhe OJQ që aplikojnë, përmes komisionit që vlerëson plotësimin e kriterëve. Ngelja e parkingut nëntokësor, në oborrin e komunës, ne e kemi elaboruar edhe me herët pse ka mbetur, është për keqardhje, tani vlerësoni ju dhe qytetarët. Fillimisht është caktuar prona, ka dal komisioni e kanë vlerësuar, iu kemi ndihmuar edhe ne me punëtorë, dhe ka dal se nuk ka diçka në atë lokacion, me vonë është kërkuar me ndal punën për hulumtime të mëtejme. E kemi ndal punën, dhe ende nuk kemi ndonjë përgjigje. Do të ishte mirë me ditur për çfarë hulumtimesh tjera flitet, që të evidentojmë në raport, që me i dhënë rrugëzgjdhje këtij problemi. Nëse diçka kam harruar, në vija me detaje japin përgjigje drejtorët.

znj. Dardana Tafili-Dauti: Përgjigje për anëtarin Agim Mani, jemi sqaruar edhe në KPF. Për numrin e certifikatave të lëshuara të gjendjes civile 34.626, ku është bërë një krahasim financiar me vlerën 28,728.10€. Ne edhe zyrtarisht e kemi marrë përgjigjen që sistemi i gjendjes civile është i veçantë prej sistemit të intranetit, në atë sistem i cili hapet për me u shikuar apo verifikuar që kërkohen nga ambasadat, gjykatat etj. figuron si dokument i lëshuar, ku rritet totali i dokumenteve të lëshuara. Të pyetje e Agim Çaka, emërtimet janë të bazuara në UA, lindje të rregullta janë ato që ndodhin në spitalin tonë, e që ne nuk kemi fatkeqësisht, vlera është 0. Lindje të veçanta janë që kanë ndodhur jashtë shtetit të Kosovës, mirëpo palët në bazë të dokumentacionit kanë ardhur e i kanë regjistruar në shtetin e Kosovës. Njëjtë është edhe me kurorëzimet speciale. Janë bërë kurorëzimet jashtë shtetit të Kosovës, ato dokumente i kanë sjellë në shtetin e Kosovës në gjendjen civile në Kaçanik dhe këto regjistrime janë kryer. Njëjtë është edhe me vdekjet speciale, vdekjet kanë ndodhë jashtë shtetit, por personat e afërt mbi bazën e dokumentacionit i kanë sjellë në Kosovë dhe i kanë regjistruar në zyrën e gjendjes civile në Kaçanik.

z. Sali Malsiu: Të pyetja e Agim Manit, që shërbimet shëndetësore me u futur me pagesë. Vendimi është marrë në këtë KK, kur unë kam qenë pjesë e legjislativit, ku është bërë çdo shërbim pa pagesë shëndetësor në komunën tonë. Është fakt se jemi e vetmja komunë ku nuk paguhet asnjë shërbim shëndetësor, për shkak të kushteve me të dobëta të komunës tonë, por prapë se prapë edhe unë jam i mendimit që të rikthehen pagesat në QKMF dhe së shpejti do të keni në KK këtë çështje dhe ju vendosni. Të pyetja e dytë, Kërkesa e Agim Çakës, për mungesën e disa barnave, ishte pyetje me vend, po e sqaroj se për barna esenciale në furnizohemi nga ministria dhe ne nuk kemi të drejtë si komunë me u furnizua me barna esenciale, se përndryshe në gjetjet e auditorit është shkelje. Për këtë arsye ne shpesh kemi bërë zgjidhje të brendshme, por realisht nuk guxojmë me furnizua QKMF me barna esenciale, se është me kontratë në qendër që nuk na lejohet neve.

z. Agim Mani: Është e vërtetë drejtor se keni qenë anëtar i KK në legjislaturën e kaluar edhe ju edhe unë kur është marrë vendimi në kohën e pandemisë, për vitin 2019 për lirim nga pagesa e shërbimeve shëndetësore për shkak të pandemisë. Vendimin që e kemi marrë në vitin 2019, i ka skaduar afati, ndërkaq në vitin 2020 kemi marrë përsëri një vendim të tillë për vitin 2020. Kur ka përfunduar viti 2020 vendimit i ka skaduar afati. Është dashur me marrë vendim edhe në vitin 2021, mirëpo nga ajo kohë nuk kemi marrë kurrfarë vendimi, ndërkaq edhe pandemia

ka përfunduar zyrtarisht, kështu që nuk është inkasuar në shëndetësi mjete, në neglizhencë të juaj për me marrë një vendim.

z. Sali Malsiu: Vendimi i vitit 2020 ka qenë për lirim nga shërbimet shëndetësore deri në përfundimin e pandemisë, ndërkaq çështja që nuk është aktivizuar deri tani, kjo nuk është për neglizhencën time.

znj. Hafize Sallahi: Raporti i nderuar Agim është shumë i qartë dhe në përputhje me planin e punës së DKRS. Unë kam raportuar për aktivitete, sepse kjo drejtori merret me aktivitete kulturore e sportive. Me duke se nuk e keni parë apo nuk dashtë me parë, se ka shumë projekte që janë mirëpritur nga qytetarët e komunës së Kaçanikut edhe projekte kapitale me mallra e shërbime dhe me subvencione dhe transfere. Të pyetja e juaj, për festivalin tradicional të lojërave tradicionale e cila mbahet në Stagovë, nuk është në planin e DKRS, kjo drejtori subvencionon të gjitha OJQ dhe dy festivale, Festivalin e fëmijëve, Festivalin e këngës Kaçaniku këndon dhe Javën e diasporës, në bashkëpunim me ministrinë me bashkëfinancim i organizojmë. Festivali që është mbajtur në Stagovë në vitin 2022, unë isha prezentë, dhe e hapa atë festival, edhe pse nuk ka qenë i paraqitur as nga OJQ tingujt e vendlindjes. Edhe këtë vit, Tingujt e vendlindjes bashkëpunojnë ngushtë me DKRS, nuk ka qenë i paraparë me u mbajt, por pas konsultimit me ministrinë, kjo shoqëri ka arritur të organizoj, kanë marrë ftesë nga kryetari, kam qenë në pushim mjekësor dhe nuk kam mundur me marrë pjesë. Arsyetimi se nuk kam marrë pjesë se e ka subvencionuar ministria, nuk është e vërtetë, sepse edhe në vitin 2022 e ka subvencionuar ministria, unë e kam hapur festivalin dhe kam marrë pjesë tri ditë rend. Sa i përket festës se 7 shtatorit, pyetja është me vend, ne e kemi sallën e 7 shtatorit ku është shpallë Kushtetua e Kosovës, salla është trashëgimi kulturore ku është e hapur për vizitorë, unë i kam bërë kërkesë ministrit Çeku që data e 7 shtatorit të futet në listën e festave shtetërore, për arsye se është gur themeli i parë, që sot ekziston parlamenti i Kosovës. Derisa ata nuk i japin rëndësi të veçantë si parlament dhe me keqardhje e themi që nuk ka asnjë deputet vizitor në Kaçanik me 7 shtator. Ne shumë lehtë mundem me bërë festë komunale, por ajo duhet të jetë festë shtetërore, besoj se jeni të pajtimit të gjithë, se festa e 7 shtatorit duhet të jetë në listën e festave shtetërore, se është akti me i rëndësishëm Kushtetuta e Kaçanikut sa i përket Republikës së Kosovës.

z. Agim Mani: Duhet të ndërlihem se patëm keqkuptime me drejtoreshën. Unë e theksova se nuk keni marrë pjesë në Festivalin tradicional të valleve dhe këngëve në vitin e kaluar. Festivali është organizuar në shtëpinë e kulturës, ka pasur artistë mbarëkombëtar. Asnjë anëtarë i ekzekutivit nuk ka dalë me i prit mysafirët as ju drejtoreshë e as përfaqësuesit e juaj. Festivali është subvencionuar nga ministria.

znj. Hafize Sallahi: Dy festivale janë subvencionuar nga ministria, festivali i SHKA, tingujt e vendlindjes, i cili mbahet në Stagovë vite me radhë dhe nuk e kuptova për cilin e ke fjalën dhe për herë të parë e ka përfituar qendra kulturore në krye me Afrim Fugën, të cilin e ka organizuar në dhjetor, ku unë edhe atëherë kam qenë në pushim. Me rëndësi ne e kemi ofruar sallën dhe ka qenë edhe akademia përkujtimore e profesorit që e patëm.

z. Agim Mani: Festivali ka qenë në mbrëmje, ka pasur artistë mbarë kombëtar, Të aktivitetet, edhe në këtë vit nuk e keni në plan 7 shtatorin.

znj. Hafize Sallahi: Nuk e kemi në plan se t'i tregova arsyet me herët. Unë po e sqaroj për të tjerët, se 7 shtatori nuk është në planin e punës dhe nuk do të jetë, se është festë shtetërore dhe është kërkesa ime drejtuar ministrit. Sa i përket aktiviteteve, edhe unë jam njeri edhe unë mundem të jem në një pushim mjekësor, dhe nëse ju i shikoni ashtu aktivitetet e drejtorisë, ju jeni ata që nuk i përcjellin aktivitetet e kësaj drejtorie, se nuk merrni pjesë në asnjë aktivitet të DKRS. Pse nuk po e potencon që është hera e dytë që mbahet Aktiviteti për ditën e të moshuarve, që nuk është mbajt asnjëherë? A keni qenë ndonjëherë në aktivitete? Me datën 17 shkurt ua kam lënë vendet e lira, por nuk keni marrë pjesë. Të lutëm mos shihni vetëm zi, nuk mundesh me akuzuar mua pse nuk kam marrë pjesë në një festival.

z. Agim Mani: Nuk ishte çështja vetëm për juve, por për krejt ekzekutivin, sepse asnjë anëtarë nga ekzekutivi nuk ka marrë pjesë në atë festival.

znj. Pranvera Loku-Zharku: Për anëtarin e KK kam vetëm një koment, pasi iu drejtua nënkryetarit me një fjalë të tillë, Sa i përket profesionalizmit, nuk është me vlerësuar profesionalizmin tim, sepse duhet të jetë një çik me lartë se unë. Për me arritur deri aty, ai ka shumë punë për të bërë.

z. Ramadush Osmani: Për pyetjen se a kemi aplikuar për thirrjen e qeverisë për projekte, po kemi aplikuar edhe vitin e kaluar edhe dje. Aplikimet janë bukur mirë të kompletuara, presim të përzgjidhemi si komunë. Po flas edhe për raportin e vitit 2022 më vërejtjet e juaja, se u debatua, ku nga 38 komuna, 11 e kanë përfutur grantin e performancës, që jemi edhe ne si komunë që jemi vlerësuar. Performanca komunale vlerësohet nga të gjitha fushat, kemi përfutur mbi gjysmë milioni euro për punën e vitit 2022. Po ndërlihem për çështjen e parkingjeve, se me pengoj fjala e Agimit që e theksoj për çështjen e parkingjeve, komuna nuk merr dhe jep parkingjet, janë procedurat, unë kam paraqitur krijimin e parkingjeve, shënjimin, ndërkaq menaxhimi i parkingjeve janë bërë me shpallje publike të cilat bëhen për 1 vit. E ka pasur Shoqata e invalidëve të luftës për 1 vit, pastaj “Pastërtia” ka operuar, komunës ia ka kryer kështu, në bazë të nenit të marrëveshjes, kompania ka kërkuar ndërprerje të kontratës. Është bërë shpallja publike, ka ofertuar përsëri SHIL, pas 1 viti përsëri do të hapet shpallje publike.

Kryesuesi i Kuvendit: Kërkoj të jeni konkret dhe të shkurtë, se kemi shumë pikë me diskutuar.

z. Adnan Reka: Pyetje për drejtorin, Cili është emri konkret i projektit që keni aplikuar, për banim të përballeshëm ose për financim të projekteve, që ka qenë sot afati i fundit me aplikuar se nuk po e din as afatin. Me thoni emrin e projektit, unë ta jap përgjigjen për projektin. E dyta, unë të raporti i juaj pata vërejtje për pasaktësitë e tuaja që i ke potencuar në raport, në rrugën “Emin Duraku”, shënjimi i parkingjeve, 13. A jeni i sigurt se janë 13 parkingje. Unë po të garantoj dhe dalim tani me anëtarët e KK i shikojmë se nuk janë 13, as në pjesën e parë të rrugës “Qamil Ilazi” nuk janë 13. Janë 29 parkingje komplet. Ju nuk keni bërë as ndarje të rrugës “Qamil Ilazi” e “Sali Bajra”. Po me vjen keq drejtor. Po ndërlihem të fjala e nënkryetarit. Cilat janë aplikimet që i keni bërë? Disa herë e përdore frazën askush nuk e tha askush nuk e tha. Ju jeni për me thënë dhe me u lavdëruar, e jo ne, ne jemi me iu shikuar juve apo i realizoni ato projekte. E ngrite çështjen e parkingut nëntokësor. Nënkryetar, shqetësimi është më i madh, mjetet shënohet në raport se janë shpenzuar, 444 mijë euro, ndërkaq parkingu nuk ekziston, kjo i bien me keq se ajo afera e Palit 53 milion, se projekti është përfunduar, ndërkaq të parkingu projekti nuk ka përfunduar. Të prokurimi, thuhet se janë shpenzuar 444 mijë euro për parkingun nëntokësor, nga 500 mijë të planifikuara, unë po i referohem raportit të ekzekutivit

z. Ramadush Osmani: Janë të shënuara parkingjet, i ke përbalë. Kërkesat për me u futur në buxhet projektet dallojnë nga kërkesat për aplikim të projekteve në ministri.

Kryesuesi i Kuvendit: Prokurimi e ka kryer punën e vet, ka zhvilluar procedurat e prokurimit, është kontaktuar kompania, ndërkaq është shkëputur kontrata nuk janë realizuar mjetet. Në raport financiar i sheh mjetet se çka ka ndodhë, besoj se jemi të qartë.

z. Adnan Reka: Nuk mundem me u pajtuar, se ne jemi duke debatuar raportin e ekzekutivit. Nëse ka ndodhë ajo, është dashur me u larguar nga raporti çështja e shumës së projektit për parkingun nëntokësor.

z. Agim Çaka: Jemi duke folur për aktivitetin e ekzekutivit për vitin 2023, ku janë shpenzuar mbi 9 milion euro, ku përshihen pagat dhe mëditjet dhe krejt shpenzimet tjera dhe kur shpenzohet kjo shumë e mjeteve, normal se ka edhe punë të mira që janë bërë. Punët e mira shihen, por unë jam i interesuar për punët të cilat nuk janë bërë. Ne jemi duke folur për projekte,

elementare, rrugë, ujësjellës, kanalizim etj. punë që munden me u bërë, se nuk po kërkojmë pse nuk është bërë fabrikë. Këto janë rrethanat që njerëzit po i nxisin për me u larguar nga vendi. Me korrigjuan se janë shpenzuar 11 milion, kjo edhe me mirë, por kur shpenzon mjete, duhet me u pa puna. Kërkesa jonë është me pasur arsyetim ky raport për aktivitetin e zhvilluar. Kur e bëra pyetjen për antishok terapi në QKMF, e dinë edhe kryetari që QKMF e as ambulancat private nuk guxon as me u hapur, pa e pasur këtë antishok terapinë dhe nuk është e kushtueshme, ndërkaq ne nuk na intereson i kujt është në obligim furnizimi. Termat që përdoren në raport, të cilat i sqaroj drejtoresha, duhet me qenë në raport, që mos të na vënë në dilemë.

Nënkryetari i Komunës: Besoj se isha shumë i qartë në fillim, se për ato punë që janë bërë e nuk i shihni, unë ua argumentova të kundërtën. Të njëjtat kritika siç e potencoj edhe drejtori, i keni pas në vitin 2022, por po del se raporti ka qenë bukur i mirë me aktivitetet të mira, se si rezultat i punës së mirë, komuna ka përfituar grantin e performancës gjysmë milioni euro, duke përmbushur kriteret e përcaktuara, Jemi falënderues prej të gjithëve zyrtarëve të organizatës komunale, se është meritë e të gjithëve, dihen kriteret, njëri nga ta është raporti i auditorit i pakualifikuar, shpenzimi i buxhetit. Edhe në vitin 2023, shpenzimi i buxhetit ka qenë 99.97%, që nuk besoj se ka ndonjë komunë tjetër këtë përqindje. Unë u mundova me i potencuar punët që janë bërë, ndërkaq a ju pëlqejnë apo jo, ajo është diçka tjetër, ndërkaq ju u munduat me i potencuar punët që nuk janë bërë. Për hir të qytetarëve e mora fjalën dhe i potencia krejt me rend punët që janë kryer.

z. Naim Beça: Parkingjet që janë në rrugën ish ‘Emin Duraku’, tani rruga ‘‘Qamil Ilazi’’, a janë legale apo jo? Këtë po e themi, sepse policia kanë dënuar për parkime aty, ndërkaq shenjat e stopimit janë larg. Nëse ato parkingje janë ilegale, duhet me u fshirë, se po të garantoj janë mbi 100 dënime që janë dhënë në ato parkingje.

Kryesuesi i Kuvendit: Ishte pyetje edhe në KPF dhe drejtori u zotua se ka me i fshirë ato parkingje, që mos me pasur më probleme.

z. Adnan Reka: Raportet duhet me qenë të sakta dhe të besueshme. Nëse raportet janë me të dhëna jo të sakta, atëherë si mund t’iu besojmë ne. Pyetja që e ngriti Naimi, me dhënë para publike me vendosë shenjat e parkingut, pastaj me dhënë para publike pas 2-3 muajve me i fshirë, është shqetësuese se si përdoret paraja publike.

Kryesuesi i Kuvendit: Askush nuk duhet me i marrë me shqetësim arsyetimet e pozitës e as thëniet e opozitës. Është fakt, që opozita mundohet me i gjetur gabimet e pozitës, dhe nesër me fituar pushtetin, ndërkaq pozita mundohet me arsyetua para qytetarëve planin e vet qeverisëse që është zotua para qytetarëve. Se kush ka pasur të drejtë, e vlerësojnë qytetarët, në bazë të fakteve.

znj. Kadrije Lika-Troni: Nuk mora përgjigje nga DA në pyetjen që e ngrita. Nga 2500 nxënës, Erodit Jakupi, në mesin e 36 nxënësve merr pjesë dhe nuk shpërblehet nga komuna. Edhe juve kryetar iu bien me u përgjigjur, se ata janë e ardhmja e jonë, se prej atyre fillon edhe sukcesi i nxënësve dhe rregullohet pak niveli i arsimit. Selman Bela, vendin e parë në gara ndërkombëtare në gara të fizikës, dhe drejtorja e nuk ka ndarë asnjë mirënjohje. Unë kam biseduar me familjarët e tyre, me kanë thënë se nxënësit janë ndier të diskriminuar. Mendova mos iu është ndarë si mirënjohje ndonjë libër, por nuk e pash askund në raport, e as kompensimi i ndonjë shpenzimi tjetër.

z. Zahir Doda: Po mendoj që nuk kam çka të përgjigjem, sepse nuk është pyetje për Kuvend. Ajo që na takon neve, i kemi përkrahur për pjesëmarrje në gara, ndërkaq mirënjohjet i kanë marrë atje, ne kemi nda mirënjohje tjetër.

z. Ramadush Osmani: Për çështjen e aplikimeve që e përmendi Agimi dhe Adnani, kërkesat për futje në buxhet në ministri të linjës, ne i përsërisim në afate të qarta, secilit projekt ia qesim shumë dhe e potencojmë se e ka projektin detal. Të thirrja për aplikime e MAPL, dje e kemi dorëzuar aplikacionin, kemi ofertuar me projekt detal, projekti: Parkun rekreativ dhe terrenet

sportive në f. Duraj, në vlerë 130,000€ shumën 50,000€ është maksimumi që mundet me dhënë ministria, pjesën tjetër buxheti i komunës. Besoj në bazë të kriterëve do të përzgjidhemi për përfitim të projektit. Të thirrja tjetër, nuk është në domenin tim me dhënë përgjigje.

z. Adnan Reka: Drejtor është fjala për dy thirrjet e fundit që i ka publikuar qeveria, thirrja e parë ishte për banimin e përballueshëm, që ka përfunduar në shkurt. Pyetja ishte: A keni aplikuar me ndonjë projekt? Pyetja dytë ishte për thirrjen që i ka ndarë qeveria 17 milion euro për bashkëfinancim të projekteve. A keni aplikuar me ndonjë projekt? Unë i lexova kriteret e projektit, duhet me qenë çdo detaj i projektit, paramasa dhe parallogaria e projektit. Nëse ke aplikuar, me dërgo emrin e projektit, që të interesohem për të.

z. Rrustem Zenuni: Me fol për raportin e ekzekutivit, punët shihen që janë bërë, ata që nuk duan me i pa, është diçka tjetër. Projektet të cilat janë dërguar në ministri, është mirë me na dërguar edhe neve, që nesër kur të ballafaqohem me qytetarë, me iu treguar, se është vështirë me u përballë me fjalë, ndërkaq çdo gjë e dokumentuar mbetet, se na ka ra me u përballë shumë herë me këtë çështje, se kemi qenë të neglizhuar nga ministrinë për projekte.

Kryesuesi i Kuvendit: Ne si komunitet e kemi punuar vet një projekt: Ndërtimin e trotuarit nga Fusha e Pajtimit - Pishina Medi dhe Ura mbi Lepenc, vlera e projektit është 1 milion e 700 mijë euro. Tani janë duke ma sjellë projektin, ta jep me veti Adnan për me aplikuar. Projekti është i kompletuar, i detajuar, tani është drejtor në obligim zyrtar për me nisur për aplikim. Projekti ka kushtuar 10,000€. Tani e ke për obligim Adnan me dërguar dhe me na ndihmuar dhe kushdo tjetër që ka mundësi, se është një projekt i rëndësishëm së veçantë për nxënës dhe këmbësorë tjerë, që mos t'iu rrezikohet jeta nga qarkullimi i automjeteve në atë rrugë, se është rrugë ndërkufitare e ndërnacionale, se në atë rrugë ka pasur edhe humbje jete të 3-4 personave.

z. Adnan Reka: Projekti duhet me qenë i kompletuar edhe me participimin e komunës, se mundet ekzekutivi mos me u pajtuar me e ndihmuar projektin.

z. Naim Beça: Kur projektet janë në interes të qytetarëve, pavarësisht kush e bënë projektin, ne si opozitë mundohemi me ndihmuar kalimin e projektit. Mos mendoni vetëm negativisht për ne si opozitë. Adnani tha iu ndihmoj dhe iu garantoj se ju ndihmon Adnani dhe ne të tjerët që jemi këtu. Unë po garantoj ndihmën prej partisë time.

z. Agim Mani: Për çështjen e participimit të projektit, a jeni në pajtim me ekzekutivin, sepse nëse e llogarisim 20% të shumës së projektit me participua komuna, i vjen diku 400 mijë euro. Ku do t'i merrni këto mjete?

Kryesuesi i Kuvendit: Shumën 220 mijë euro ekzekutivi e ka ndarë për këtë projekt, ndërkaq mundësia është me u plotësuar shumën qoftë edhe 400 mijë euro, përmes bartjes së mjeteve nga viti i kaluar. Me rëndësi është me kaluar projekti, se është shumë me prioritet.

znj. Ardita Rrahmani: Kërkoj një pauzë të KK 10 minuta, sepse nëse raporti financiar zgjatë sa raporti i ekzekutivit, po bëhet shumë kohë.

Kryesuesi i Kuvendit: Pauzën do të bëjmë pas përfundimit të diskutimit të raportit financiar. Diskutime të tjera nuk ka, Raporti i Ekzekutivit të Komunës nuk del në votim, kështu që konstatohet se Kuvendi i Komunës

NJOFTOHET

Me Raportin Vjetor të Ekzekutivit të Komunës për vitin 2023/ Lënda: 01Nr. 104/02-4379/24.

3. Raporti Vjetor Financiar për periudhën, Janar – Dhjetor 2023;

Kryesuesi i Kuvendit: Për këtë pikë u diskutua edhe gjatë pikës 2, e hapi diskutimin:

znj. Ardita Rrahmani: Nuk desha me diskutuar shumë të raporti i ekzekutivit se ajo pasqyron punën dhe obligimet e juaja ndaj qytetarëve që i keni premtuar, ndërkaq të raporti financiar mundmi me dhënë kontributin secili nga ne në KK, pozitë e opozitë. Buxheti i vitit 2023 ka qenë 10,674,689.00€, ndërkaq me bartje të mjeteve ka kaluar shuma 12,035,894.29€. Shpenzimet kapitale 2,851,313,00€, suficit keni thënë se janë 3,709€ nëse nuk gaboj të deklaruar në raport dhe në mbledhjen e KPF. Të hyrat indirekte 440,221,00€, ku do të destinohen këto të hyra, në investime kapitale apo në realizimin e kontratës kolektive? Sa është shuma e kontratës kolektive që ka komuna obligim me paguar? Të grumbullimi i të HVK sipas drejtorive, DBF, të planifikuara 487,095,00€, realizimi është 518,982,33€, të TP planifikuara 250,512.00 €, realizimi, 338,746,62€. Të Bujqësia dhe Pylltaria, të planifikuara 16,300.00€, të realizuara 36,762,38€, me ndërrim të destinimit të tokave me diku 20 mijë euro diferencë. Të Shëndetësia, planifikimi 30,000.00€, realizim 7,880.00 €, planifikimet po janë fontanë dëshirash në raport me realizimin. Kur është dallimi në planifikim dhe realizim 2-3 mijë euro, në rregull, mirëpo pas sa vitesh qeverisjesh, kur ju drejtor jeni në udhëheqje të kësaj drejtorie ka kohë, pse ky dallim në mes planifikimit dhe realizimit, po flasim për një shumë të madhe në mes planifikimit dhe realizimit. Të subvencionet, kryetar nga Zyra e juaj janë ndarë 2,525€ dhe nga DSHPE 36,500€ për BIK për shpenzimet mortore. Pse janë të ndara këto mjete nga dy sektorë. Të DKRS, të subvencionet në tabelën e fundit thuhet janë 450€, pagesa të tjera. Çka janë këto pagesa edhe pse shuma nuk është e madhe. Të DAP thuhet se janë bërë shpenzime 5,943 € për energji elektrike dhe 5,715€ të mbeturinat. Pse është kjo diferencë kaq e vogël, diku 100€, duke ditur çmimin e energjisë dhe mbeturinave? Përgjigjen mundet drejtoresha të jap këtu. Të subvencionet të DA, është e vërtetë se ka bërë mbështetjen e transportit të nxënësve, por në formë selektive, ku e kam bërë kritikën ku janë mbështetë disa nxënës të f. Gllloboçicë, i disa nxënësve tjerë nuk iu bëhet pagesa.

z. Agim Mani: Raporti nuk është i kompletuar, me qëllim apo pa qëllim, nuk e di. Të Investimet Kapitale-IK nuk është ofruar tabelë? Duhet me u përgjigjur për këtë, ndërkaq të MSH është tabela. Nëse nuk janë në formë tabelare shpenzimet, është vështirë me i kuptuar. Pyetje: Sa mjete janë bartur nga të HVK, sa ka kushtuar mirëmbajtja e rrugëve lokale dhe rurale? Po të ishte në raport pasqyra e IK, ishim bazuar në raport, por nuk është. Për derisa nuk e kemi raportin e IK nuk e di për çka po diskutojmë ne. Atëherë për me kuptuar, duhet me ngrit pyetje. Totali i IK duhet me qenë të detajuar. Sa ka kushtuar Ndërtimi i parkingut nëntokësor? Të MSH shpenzimet e kontraktuara janë 203,000€, nuk dihen për çka. Të mirëmbajtja e rrugëve lokale 392,000€, janë marrë nga kategoria e MSH, keni bërë asfaltimin e rrugëve me këtë shumë, ndërtimin e mureve, kjo është keq kategorizim. Të subvencionet të DZHET, ku u përmend çështja e profesionalizimit, ka pasur subvencion SHKA “ Gryka e Kaçanikut”, d.m.th. me zhvilluar ekonominë, kjo është jo profesionalizëm. Se nuk zhvillohet ekonomia e komunës duke i subvencionuar SHKA.

Kryesuesi i Kuvendit: Tabela e investimeve kapitale ka qenë në të gjitha raportet me të gjitha të dhënat, në këtë jo, po pajtohem me Agimin se mungon tabela, sigurisht është bërë ndonjë gabim, besoj se drejtori e sjellë në ndonjë mbledhje të radhës.

z. Adnan Reka: Kryesuesi e dha një arsytim, por nuk ka arsytim nëse mungojnë tabelarët dhe nuk është e njëjtë si me i pasur sot tabelarët, sikur me na i sjellë me vonë. E dyta, kjo nuk është hera e parë që mungojnë tabelarët. se mbi bazën e raportit duhet me diskutuar. Kur iu akuzuam me herët, ju patët replikë. Shifrat janë të pasakta dhe të pavërteta, ndërkaq ju mundohen me na sqaruar realizimin e buxhetit. Derisa nuk ka informata ashtu si e parasheh ligji e rendi, për mua kjo është manipulim. Të Shpenzimet kontingjente, kam pyetje: A është e vërtetë se shpronësimi e ka arritur vlerën mbi 500,000€. E dyta, të ndërtesa e Handikos, po shohim investime, në anën tjetër e kemi një dokument të ministrisë që ka thënë se është në sh përputhje me ligjin ai objekt. Ai objekt nuk e ka aty vendin, pse po investojmë në të, kur është në kundërshtim me ligjin? Raporti i vitit 2023 në raport me atë të vitit 2022, të HVK ka

sh përputhje, në vitin e kaluar ka tjera shifra, tani janë tjera shifra, pse u ndërruan shifrat, se ato kanë ndodhë më, janë kryer? Kur po diskutojmë ne për raporte të paqarta, duhet me na mirëkuptuar, duhet ditur se ekzekutivi i ka punët e ndara me legjislativin, ne i kemi punët tona, Ne po bëjmë kritika dhe shpesh po ballafaqohemi me juve, gjë që është e pa arsyeshme. Qëllimi jonë është me i dërguar çështjet përpara, se kritikant i dërgojnë çështjet përpara.

z. Rustem Zenuni: Të shpronësimi janë 58,000€, e kam pyetur edhe drejtorin, bëhet fjalë për një rast që është në gjykatë. Edhe mua me intereson me ditur, e jo kështu duke bërë spektakël. Askush nuk e përmendi, se paku as Adnan për përfitimin e Grantit të performancës në vlerë 500,000€.

z. Agim Çaka: Është e vërtetë që pas raportit të ekzekutivit, është raporti financiar, i cili paraqet në shifra të gjitha ato aktivitete, se nuk mundën me u kryer punë pa mjete financiare. Për këtë arsye, raporti financiar duhet me qenë i saktë kur t 'na vjen, me pasur arsyetim financiar, ndërsa a është punuar apo jo, e diskutuam në pikën paraprake. Për atë që është punuar, duhet dokumentuar me shifra, fakte me tabela, se për një projekt janë shpenzuar kaq mjete, që ne pastaj me diskutuar, a kanë qenë të arsyeshme apo jo ato mjete. Nëse nuk ka material të mjaftueshëm me diskutuar, atëherë këtu ndërpritet edhe diskutimi. Aktivitetet u përmenden me herët, u dhanë edhe arsyetimet, u shprehen pakënaqësitë për to. Mendoj në këto mbledhje mos me shkuar në atë nivel që dikush po ia bënë për inati. Ekzekutivi paguhet për me punuar, është krejt normale, ne diskutojmë kur nuk punohet.

z. Bahri Selimi: Të pyetja e Arditës, ngritja e buxhetit është ashtu si e potencove, buxheti i miratuar është 10,674,689.00 € dhe buxheti final 12,035,894.29€. Rritja ka ndodhë për shkak të rritjes së kostos së pagave me ligjin e ri prej 536,000€ dhe të hyrat e bartura nga vitet e kaluara 814,722€ dhe 10,000 € grante nga donatorët. Shpenzimi i buxhetit si drejtori, mendojmë se ka shkuar si është me së miri, shpenzimi me i madh ka qenë të GQ, mbetja e GQ 3 mijë 17 euro e 14 cent. Ky është suficit i regjistruar, është mjaft minimal. Të HVK 1 milion që bartën në vitin 2024. Shpenzimi i tyre, fillimisht bartën në ministri aty ku kanë mbetur pa shpenzuar, i orientojmë në projekte të vitit të kaluar që kemi obligime, pastaj në projekte që duhet të shtohen mjete në kode ekzistuese apo në ndonjë projekt tjetër, siç e përmendi kryesuesi, bashkëfinancimin e komunës në ndonjë projekt në ministrinë e linjës, Mosbarazimi me planifikim, asnjëherë nuk barazohet, p.sh. të DBF të TP kemi tejkallim të HVK se kemi pasur inkasim të mirë, ka ndonjë drejtori me pak planifikim, realizim me të madh. Shqetësim është nëse nuk realizohen të hyrat, ndërkaq ne i kemi tejkalluar për 203,000€. Planifikimi i të HVK ka shumë faktorë. Të DUKMM mundem me planifikuar shumë të hyra, por nëse ende nuk është miratuar PZHK ka mungesë të hyrave. Planifikimi bëhet të gjitha drejtoritë, dallimet janë të paketa, por asnjëherë mos prit me ia qëlluar 100%. Ne sa herë insistojmë me realizuar sa me tepër të HVK. Me BIK e kemi kontratën dhe i financojmë të gjitha rastet që ndodhin, planifikimet janë nga DSHPE, ka pagesa që kryhen nga ndonjë drejtori tjetër apo nën programi buxhetor, ku ka pasur mjete. Shpenzimet kapitale, ne e kemi obligim çdo herë me raportuar, IK janë raportuar sipas klasës e jo me kod si po i kërkoni, se ministria na obligon sipas klasës se sa janë në rrugë, ura, lumenj, ndriçim publik, por ne nuk do të thotë se nuk mundem me ua dërguar listën e shpenzimeve sipas projekteve me emërtim. Mirëmbajtja e rrugëve lokale, e dini sesa janë, se njëherë i kemi paraqitur në tabela. Subvencionet të DZHET, për SHKA, kjo ndodhë ndonjëherë kur nuk kemi mjete, i marrim të ndonjë drejtori tjetër, shqetësuese është mos me financuar apo mbetur borxh shoqërisë. Të kontingjentet, shpenzimet mbi 500,000€ kontingjentet janë komplet mbi 2 milion euro. Nuk është se komunës i ka kushtuar shpronësimi 500,000€, as totali prej 2 milion e 555 mijë kontingjentet, ne të drejtoria e Arsimit, ende nuk i kemi kryer obligimet sipas kontratës kolektive. Mjetet janë paraqitur, por kontingjentet ende nuk kanë ndodhë, por mundën me ndodhë. Të IK e kemi një shpronësim afër gjimnazit, është vlerësuar prona nga MEF 58,000€. Ato mjete i kemi paguar, ende nuk i kanë shkuar në llogari të obliguesit, por janë në BQK, ai nuk i ka pranuar mjete dhe ka bërë ankesë në gjykatë, në fund të vitit 2023 ka ardhur vlerësimi i gjykatës se ajo pronë ka vlerë me të madhe. Zyra juridike

ia ka prapsura vlerësimin e gjykatës, presim të mbetet vlerësimi i ministrisë, sepse ministria nuk vlerëson 2 herë. Kontingjentet priten me ndodhë të arsimit, janë afër 2 milion euro, në momentin që vijnë duhet me i zbatuar. Komuna është gatshme me i ekzekutuar sivjet këto mjete, ndoshta në kurriz të ndonjë projekti kapital. Pyetjet që nuk jam përgjigjur, ua dërgoj me email.

z. Agim Mani: Mungesa e raportit na sjell problem, se nuk kemi me i kuptuar sa duhet. Të mirëmbajtja e rrugëve, e theksove se është në raport, është 392,000€ të MSH. Ju e dini që të MSH me këto mjete janë shtruar asfalt, janë ndërtuar mure, kurse në prokurim thuhet se janë 475,000€. Cila është e saktë? Të HVK, thuhet 198,000€, ndërkaq nuk keni qenë në gjendje qytetarëve me ua fal tatimin në pronë, me arsyetimin që kemi mjete të mjaftueshme. Në njërin anë nuk ia falni TP, në anën tjetër i keni obliguar qytetarët me paguar, se mospagimi, ndëshkohen. Realisht nuk i shpenzoni mjetet, kur thoni se po bëhet bartja e mjeteve mbi 1 milion, sa ka qenë buxheti fillestar, buxheti aktual dhe finalizimi. Ku keni me i marrë mjetet tjera, me i bartë, se në total thuhet se kanë mbete 814,722€, ku keni me i marrë edhe 300,000 € me i bartë?

z. Bahri Selimi: Kanë me u bartur mjetet që janë tejkualuar nga planifikimi, këto janë mbi 239,000 €. Në mbledhjen e muajve vijues kemi me marrë vendim për rritje të buxhetit, për tejkualim të mjeteve, merret vendim në veti dhe barten të hyrat.

z. Agim Mani: Në buxhetin final hynë të grantit: të HVK, të hyrat e bartura, të hyrat indirekte, realizimi është në total. Mbetja është 814,000 €, ndërkaq ju po i bartni mbi 1 milion euro.

z. Bahri Selimi: Pse nuk po i referohesh një tabele me poshtë, ku është shënuar bartja e mjeteve, se me herët thatë se nuk e keni paraqitur bartjen. Adnani tha, pse nuk po aplikoni për projekte dhe doli që sot është 29 shkurti dhe e dorëzuar një projekt, e nisi kryesuesi projektin.

z. Adnan Reka: Detyrimet kontingjente mbi 583, 395€ që duhet vetëm një personi t'i paguhet 549,571€. Është e qartë në raport që këto fonde bllokohen nga BQK në fondin e mirëbesimit.

z. Bahri Selimi: Borxhi i zyrtar është 58,000€ familjes Krivanjeva. Ata kanë nuk janë pajtuar me vlerësimin e ministrisë dhe kanë bërë ankesë. Pse Adnan po i beson një vendimi që nuk është përfundimtar, ajo është dëshirë e ankuesit. Atë vlerësim Zyra juridike e komunës e ka prapësuar. Në momentin që lënda vjen këtu, gjasat janë me ndodhë 50 me 50. Vlera është jo reale dhe kontingjentet nuk janë shpenzim.

z. Adnan Reka: Po i besoj se nuk është hera e parë që janë paguar kontingjentet në shuma marramendëse. E kemi rastin të tushët. Është e njëjta situatë, ku është paguar vlerë e madhe, kjo komunë ka paguar vlera të paarsyeshme, nuk po theksoj me shuma. Ju po bëni veprime paraprake. Pse nuk bëhet njëherë shpronësimi, pastaj me ia bërë pagesën? Edhe këto 3 lëndët që kemi me i diskutuar, ministria i ka kthyer vendimet, ndërkaq ju murin e keni ndërtuar dhe me një të ardhme të afërt pronari të paditë dhe kërkon vlerën 200 mijë për 1 metër. Gjykata thotë jo 200 mijë, por 150 mijë. Ne po e kritikojmë këtë formë, lë të kuptojnë edhe KK edhe qytetarët se ju nuk po punoni mirë, pavarësisht se po mundoheni me mbuluar me debat.

z. Bahri Selimi: Pse po thoni një të pavërtetë Adnan?

Kryesuesi i Kuvendit: Ne mund të gabojmë në vlerësime dhe diskutime. Tendencat duhet t'i lëmë anash. Ajo që është shpronësuar të tushët, ne e dimë e cilës kohë është ajo lëndë. Ajo çështje është përfunduar, por jo qysh e potencuat ju Adnan, janë dokumentet që e argumentojnë, se është një vlerë tjetër dhe sipërfaqe e tokës tjetër. U pajtova për tabelën e IK që duhet me qenë pjesë e debatit, por nuk pajtohëm për një çështje, veç se doni me u bërë do punë të mëdha, e që me vlerësimin e pronave nuk merret komuna, se kjo është ligj, merret Agjencioni Kadastral me MEF. Ata e caktojnë një vlerë të pronës, vendosin një çmim, komuna e zbaton vendimin. Nëse pala nuk pajtohet, është gjykata ku mundet me u ankuar. Kjo është

procedura. A iu ka dashur ai vend komunës, sigurisht që po, e dimë edhe vlerën sa u privatizua, por a po funksionon sistemi i drejtësisë, ne nuk kemi kompetenca me ndërhyrë në atë sistem. Komuna nuk ka asnjë faj në këtë drejtim, komuna e ka shpallë me interes publik, për rregullimin e busteve dhe parkut të qytetit, prona është privatizua nga AKP, me një vlerë dhe një çmim të caktuar, ka qenë publik privatizimi, ndërsa tani bisedohet për një vlerë tjetër, ndërkaq ajo pronë nuk i ka 1 vit që është shpronësua me një vlerë të caktuar.

z. Adnan Reka: Pse ne nuk po i kryejmë punët paraprakisht, pastaj ajo vlerë që është me një vendim gjyqësor paguhet, por ne po e shpallim me interes publik fillimisht, po ndërtojmë, përkundër që pala nuk është pajtuar, ndërkaq ne po i kryejmë procedurat dhe po kërkojmë nga pala me kërkuar një çmim që ai nuk e pranon. Për rastet që na janë kthyer, pse me nxituar ne me ngritur mure, ende pa u përfundua lënda? Lë të kryhen të gjitha procedurat e lëndës, pastaj me u bërë shpronësimi, për atë unë po e gjykoj formën.

z. Rustem Zenuni: E kam një shqetësim të raporti financiar, të mallrat dhe shërbimet, pagesa për kompaninë “Pastërtia” mbi 31,730.72€. Unë nuk po mundem me kuptuar pse po ndodhin këto. Përderisa ndërmarrja nuk punon me mbrojtur interesin e vet, paguan komisione të aksionarëve që është e kushtueshme, unë mendoj që ne nuk duhet paranë publike ne me shpenzuar aty. Kërkoj një Raport financiar të ndërmarrjes publike ‘Pastërtia’ njësia Kaçanik, se ne e kemi komisionin e aksionarëve që e mbikëqyrë atë ndërmarrje. Në njërin kjo ndërmarrje kërkon me i ndihmuar në anën tjetër paguaj komisione rreth 7,000 € në vit, pa bërë asgjë ato komisione, unë nuk e kuptoj këtë.

z. Bahri Selimi: Përgjigjen Rustem ua kthej me shkrim.

z. Qamil Stagova: Për pronën e tushëve, që e kanë marrë një shumë të madhe të parave prej komunës, gjykata e ka aprovuar kërkesën e komunës, tushët janë të obliguar me i kthyer mjetet, dhe vazhdon një procedurë, ku është duke u bërë vlerësimi i pasurive të kësaj familje. Të Handikos, mbetem borxh me dërguar, e di se keni kontaktuar me ministrinë, jemi në marrëveshje me ta për këtë çështje.

z. Adnan Reka: Vendimi është në kundërshtim me PZHK, sepse ajo pronë ishte për terrene rekreative sportiv, ajo pronë është e ndaluar për banim. A e kemi një vendim të ministrisë se ai vendim është kundërligjor?

z. Qamil Stagova: Ashtu kanë mbet ajo pronë, ndërkaq nuk ishte krejt sipërfaqja për terrene sportive. Vendimi ka ardhur, por në një pikë është kërkuar nga ministria informata shtesë lidhur me PZHK.

Kryesuesi i Kuvendit: Në afat ligjor mua nuk me ka ardhur kurrfarë vendimi. Çdo vendim që vjen në afat ligjor, unë e sjell në KK për shfuqizim. Çka ka ardhur në drejtori, unë nuk e di. Mua nuk me ka ardhur kurrfarë vendimi nga ministria për shfuqizim në KK.

z. Adnan Reka: Unë e kam parë vendimi e ministrisë për Handikos që thekson se vendimi është në sh përputhje me PZHK, ndërkaq ne po vazhdojmë me investuar në diçka që është në sh përputhje me ligjin.

Kryesuesi i Kuvendit: Ka vendime të ministrisë që kërkojnë sqarime shtesë. Besoj se drejtori i ka dërguar sqarimet. Çdo vendim që na vjen për shfuqizim, e shfuqizojmë, përndryshe ministria e dërgon në gjykatë. Ne nuk kemi asnjë vendim që ka shkuar në gjykatë. Nëse e kanë dërguar pas afatit ministria vendimin, ai është i pavlefshëm.

z. Adnan Reka: Kemi pasur edhe vendime tjera që ministria ka kërkuar informata shtesë, përkundër sqarimeve të komunës, janë kthyer përsëri negativ.

z. Agim Çaka: Drejtori nuk nevojë aspak të ndihet në siklet, ai duhet me sqaruar buxhetin, të hyrat, pagesat për secilin pozicion, krejt këto duhet me qenë të pasqyruara në raport saktë.

Pastaj secili përgjigjet për mjetet ku kanë shkuar në secilin projekt. Drejtori duhet me u bërë merak vetëm kur avullohen mjetet, përndryshe drejtori i financave e ka punën me të lehtë në raport me drejtorët tjerë se ku kanë shkuar mjetet.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, raporti nuk del në votim, kështu që konstatohet se Kuvendi i Komunës

NJOFTOHET

Me Raportin Vjetor financiar për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2023/ Lënda: 01Nr. 400/03-2904/24.

Pas përfundimit të kësaj pike, KK bëri një pauzë, pas pasues vazhdojë me punimet e mbledhjes aty ku kanë mbetur të pika 4. Prezentë për momentin janë 20 anëtarë.

4. Informatë për përfundimin e Gjysmë vjetorit të Parë të vitit shkollor 2023/2024;

Kryesuesi i Kuvendit: Kemi mbetur të pika 4, kuorum ka, vazhdojmë, drejtori është këtu, e hapi diskutimin:

znj. Arlinda Rakoci-Raka: Është shqetësuese numri i mungesave të nxënësve në shkolla të larta, janë 29990 mungesa për gjysmë vjetorin e parë, shprehur për kokë nxënësi i bien nga 32 mungesa. Po ashtu janë të humbura 751orë, për afër 9 mësimdhënës. A keni marrë ndonjë veprim në këtë drejtim, pasi këto mungesa çdo vit janë të larta?

z. Agim Çaka: Cili është suksesi i nxënësve në këtë gjysmë vjetor në raport me vitin e kaluar të njëjtës periudhë? A është me i mirë apo me i keq suksesi, e njëjta vlen për mungesat e arsimtarëve dhe të nxënësve?

z. Adnan Reka: Kam një kërkesë për drejtorin: A mundesh me ua mbajtur një ligjëratë apo trajnim ekzekutiv, sesi duhet të shkruhet raporti, se raportet e ekzekutivit janë tepër të dobëta? Në fillim kur e keni marrë mandatin, je zotuar për hartim të raporteve të mira dhe e keni mbajtur fjalën. Është raport i DA i punuar jashtëzakonisht mirë, unë e pranoj edhe publikisht.

Kryesuesi i Kuvendit: A keni Adnan diçka rreth pikës, se nuk jeni duke diskutuar në pikë, me thënë drejtorit me iu mbajtur trajnim të tjerëve.

z. Adnan Reka: Premtimet që i keni dhënë drejtor, se nuk do të dalësh në pension pa e ndërtuar shkollën “Emin Duraku” dhe pavarësimin e shkollës së Kovaçecit. Besoj se keni me i realizuar. Të shkolla e Kovaçecit, 14,000 € janë dhënë për sanimin e kulmit, mjetet janë dhënë, kulmi ende pikon. E di se nuk mundeni me dhënë kontribut shumë këtu, se me tepër nënkryetari e ka përcjellë këtë çështje.

znj. Florina Lika - Vishi: Falënderoj drejtorin e arsimit dhe kabinetin e tij. Si drejtori keni dhënë kontribute për vite me radhë, desha t’iu përgëzoj për punën e mirë që e bëni në të mirë të qytetarëve dhe nxënësve që frekuentojnë në shkolla nga zonat rurale, që cilësohen si zona me të largëta, duke i subvencionuar edhe me mbulimin e shpenzimeve të transportit si dhe bartjen e tyre edhe të fëmijëve me nevoja të veçanta në arsim, duke ua lehtësuar sadopak barrën familjeve, si dhe mundësinë e përmbushjes së njëres nga drejtat e nxënësve për arsimin dhe edukimin e pandalshëm. Respekt dhe faleminderit drejtor për punën tuaj!

z. Selajdin Troni: Edhe unë e falënderoj drejtorin për punën që ka bërë, ndërkaq edhe unë kërkoj të shqyrtohen mundësitë e ndarjes – pavarësimit të shkollës së Kovaçecit, sepse i plotëson të gjitha kushtet. Duhet me kërkuar në nivel qendror me u ndryshua edhe ligji dhe Udhëzimi administrativ dhe me u ndarë kjo shkollë.

z. Naim Beça: Çështja e bartjes së nxënësve është obligim ligjor. Me intereson të di, A ka diçka rreth shkollës fillore ‘Emin Duraku’, ndonjë iniciativë për atë shkollë, a janë përpiluar dhe dërguar krejt raportet?

z. Zahir Doda: Është rregull që në fillim dhe mbarim të viteve shkollor, me i informua anëtarët e KK. Informata si çdo herë, edhe kjo është korrekte, po mundohem me i dhënë përgjigje, përfshirë edhe falënderimet, të cilat ishin me vend. Çështja e mungesave të nxënësve, është e vërtetë dhe nuk jemi duke ditur me iu bërë zgjidhje. Ne i përfillim UA atë çka na lejojnë, ka shumë nxënës që na kanë mbetur në shkolla tjera me transfere mujore, tremujore, ashtu qysh jepet me UA, por edhe me provime të klasës, as prindi nuk mundet me sjell në shkollë, ndërkaq mungesat duhet me ia shënuar. Çështja e mungesave të nxënësve është problem jo vetëm të ne, por edhe në nivel të Kosovës, bile veç janë duke u rritur, se ishte pyetje e Agimit. Të mungesat e mësimdhënësve, e kam futur në funksion ndalesën e mëditjeve. Ka ndalesa për mësimdhënës për mungesa pa arsye, por edhe çdo orë tepër iu paguhet punë shtesë, nuk iu kam asnjë borxh, pa hyrë në pjesën e kontratës kolektive. Të pyetja e Agimit, pos të mungesat, nuk kam bërë ndonjë krahasim të suksesi nuk ka bërë, nuk i kam shikuar mesataret, se me tepër janë formale mesatarët, se kështu është sistemi jonë. Të pyetja e Adnanit, keni të drejtë Adnan, ne i bëjmë veç e veç raportet, kur të përmbliidhen mund të përzihen, ishin përzier edhe të DA, por nuk kam çka me bërë. Të ky raport, jam munduar me ruajtur nivelin, mund të këtë ndonjë defekt, se unë jam i matematikës. Të trajnimet nuk e kam atë të drejtë. Të investimet, në kuadër të renovimeve, ka qenë shkolla ‘Emin Duraku’ dhe kulmi i shkollës në Kovaçec. Është bërë paramasa, shuma e projektit, është përzgjedhë prokurimi kompaninë që ka qenë me e lira, menaxher ka qenë Jehona Hoxha, kam kontaktuar se kam të drejtë, se prokurimin nuk kam të drejtë, ka ardhur disa herë, jam ngjitur edhe vet në kulm, edhe mua me është dukur shuma e madhe, por ata me kanë thënë që kaq kushton. Informatën prej përgjegjësit e kam se, kulmi nuk pikë. Kjo është informata ime zyrtare. Unë mundem me i besuar me tepër përgjegjësit se e kam përgjegjës timin, ndërkaq ju mundeni t’ me bëni politikë këtu. Shkollën ‘Emin Duraku’ me do t’ia fillojmë ndërtimin, nuk e di se a mundem me përfunduar se jam afër pensionit. Që 5 vite me radhë dërgoj dokumentacion në ministri, mundemi me ua argumentuar, shkojmë bashkë në ministri, ata lë të flasin, unë vetëm do të dëgjoj, të gjithë kanë me pa që dokumentacioni është komplet. Shkolla ka kodin, kompania projektuese e caktuar e ka për obligim me dizajnuar projektin, ata kanë qenë 3 herë këtu, dje ma kanë dërguar njërën prej modeleve, që detyrën projektuese ia kishte dërguar ministria 540 nxënës dhe shkolla del e vogël. Sot ma kthyen që e kanë marrë informatën se kam reaguar menjëherë, mundem me argumentuar faktin, e kanë marrë numrin e nxënësve dhe projekti do të korrigohet. Janë thirrur të gjithë inxhinierët, se projekti është për Kaçanikun, me kanë se do t’ me ftojnë edhe mua ende pa përfunduar projekti, dhe sipas tyre projekti është me prioritet me filluar, ndërkaq që ka pak mjete, këtu kam reaguar në Zyrën e Infrastrukturës në ministrinë e Arsimit, kam kontaktuar përveç udhëheqësve të zyrës edhe me 2 deputetë të VV, Dimal Basha dhe me një tjetër, mundeni me takuar me ta. Ai me ka zgjatur dorën se projekti do të kryhet. E kam dhënë maksimumin me përkrahje edhe të kryetarit dhe ai projekt sivjet ka me filluar, projekt ky shpresoj të gëzojnë të gjithë qytetarët e komunës, shpresoj të realizohet sa jam në këtë pozitë. Gjithashtu nga ministria e Arsimit do të filloj projekti i ndërtimit të Çerdhes së fëmijëve në ZK Rekë për komplet atë zonë. Është bërë projekti detal, është duke u bërë leja e ndërtimit, ministria ka premtuar se do të investojnë menjëherë. Çerdhja që ka kaluar me projekt detal në MASHT, por që është ndal për IPA fondin, për shkak të punës së mirë të qeverisë, IPA fondi është ndalë përkohësisht dhe nuk fillon projekti. Kur niset ky projekt, nuk e di. Për krejt këto punë nuk kam bërë reklamë. Shkollën e Kovaçecit jemi për me pavarësua, unë do të kryej pjesën time, kur të rregullohet çështja e pronave, leja e ndërtimit, është përgjegjësi që i ka marrë detyrat, e kam përkrahjen e kryetarit, shkolla i plotëson kushtet me UA me u pavarësua.

z. Selajdin Troni: Sa e di unë, çështja e pronave të shkolla e Kovaçecit është kryer këtu në KK. Është bërë kompensimi i tyre kur është ndërtuar shkolla, aq sa ka dhënë pronari edhe ka

marrë. Kulmi i shkollës edhe mua me është dukur se ka kushtuar shumë, ndërkaq përgjegjësi ka thënë se puna është kryer mirë.

z. Zahir Doda: Për çështjen e pronave të shkollës në Kovaçec, mund të bisedoni me përgjegjësin e projektit.

z. Adnan Reka: Se a pikë kulmi i shkollës, nuk është çështje e besimit dhe mirëbesimit, por e vërtetësisë. Ne mundemi me vërtetua se bashku me drejtorin e DA dhe Selajdinin. Çështja e ndarjes së shkollës, mendoj se nuk e hiqni përgjegjësinë me arsyetimin që e theksuat. Çështja e rregullimit të pronës, nuk është në obligim të përgjegjësit të shkollës dhe komunitetit, por të komunës. Shkolla është ndërtuar nga institucioni e jo në bazë vullnetare, kështu çështjet duhet të përfundoj përmes institucionit. Përformanca e ekzekutivit matet sa keni realizuar e jo sa jeni përpjekur.

z. Agim Çaka: Pyetje për drejtorin: Të Gjinnazi “Skënderbeu”, është realizuar projekti, duket bukur ajo pjesë. A është e planifikuar me u vendosur rrethoja apo do të ngelë e hapur? Mendimi im është të jetë e kufizuar, që vetëm nxënësit dhe personeli i shkollës me pasur qasje aty, sepse është me e sigurt për nxënësit, e jo me lënë si shëtitore, përkundër që po shkojmë kah demokratizimi.

z. Zahir Doda: Puna me e madhe është bërë, ka nevojë për korrigjime. Kjo pjesë do t’i lihet kryesisht drejtorisë së shkollës, se edhe kjo që është bërë, është me propozimin e shkollës, ka fjalë të mira për punën që është për oborrin, ashensorin. Ata kanë me kërkuar sesi donë me qenë ajo pjesë, besoj se do të jetë e mbyllur, dhe kryhet me mallra e shërbime. Në dy shkolla të mesme kam planifikuar me pas edhe sigurimin, se ka nevojë. Sa i përket performancës, nuk e vlerëson vetëm KK, unë ndihem mirë në mesin e të gjithë drejtorëve të Kosovës, këtë e vlerëson tjetërkush.

z. Adnan Reka: A jeni në dijeni se përkundër ashensorit të ndërtuar në shkollën “Skënderbeu”, nxënësit me nevoja të veçanta bartën në krah, për me shkuar në kabinet të informatikës? E kam informacionin e saktë, besoj se ju e dini pse nuk përdoret ashensori.

z. Zahir Doda: Nuk e kam këtë informatë, sa herë kam shkuar aty, kam pa se janë ngjitur dhe zbritur nxënësit edhe me karrocë. Mundem me thirr drejtorin me marrë këtë informatë, por tani jemi në KK.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, informata nuk votohet, kështu që konstatoj se Kuvendi i Komunës

NJOFTOHET

**Me Informatën për përfundimin e Gjysmë vjetorit të Parë të vitit shkollor 2023/2024/
Lënda: 01Nr.104**

5. Informatë e menaxhimit të burimeve njerëzore për periudhën Janar – Dhjetor 2023;

Kryesuesi i Kuvendit: Materialin e keni marrë, shefja e zyrës është këtu, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë konstatoj se Kuvendi i Komunës

NJOFTOHET

**Me Informatën e menaxhimit të burimeve njerëzore për periudhën Janar – Dhjetor 2023/
Lënda: 01Nr. 104/02-4327/23.**

6. Raporti vjetor lidhur me auditimet e brendshme të kryera dhe aktivitetet e Auditimit të Brendshëm për vitin 2023;

Kryesuesi i Kuvendit: Është një informatë që po kërkohet me u sjellë në KK, për shkak se është në fushën e treguesve të performancës. E hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Ky raport i Auditimit të brendshëm është këshillues, mirëpo mendoj se nuk është duke e kryer punën mirë, se nuk është duke e këshilluar mirë ekzekutivin, se po të këshillonte mirë, raportet e ekzekutivit dhe ato financiare do të bëheshin me mirë. Në anën tjetër nuk ka dhënë rekomandime që ne t’i dimë, raporti nuk ka rekomandime.

Kryesuesi i Kuvendit: Raporti që i trajton çështjet me së miri është, Raporti i Zyrës Kombëtare të Auditimit, i cilin e sjellim në KK për trajtim. Diskutime të tjera nuk ka, atëherë konstatohet se Kuvendi i Komunës

NJOFTOHET

Me Raportin vjetor lidhur me auditimet e brendshme të kryera dhe aktivitetet e Auditimit të Brendshëm për vitin 2023/ Lënda: 01Nr. 470/03-4297/24.

7. Propozim Vendim Paraprak Për Dhënien e Pronës së Paluajtshme të Komunës në Shfrytëzim Afatgjatë për 99 vite;

Kryesuesi i Kuvendit: Materialin e keni marrë, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua 14 votë Për, Kundër votë nuk ka, Abstenim 6 nga LVV. Prezentë 20. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM PARAPRAK

Për Dhënien e Pronës së Paluajtshme të Komunës në Shfrytëzim Afatgjatë për 99 vite/Lënda: 01Nr. 350/01-4450/24.

8. Propozim Vendim Për Formimin e Komisionit Vlerësues Për Dhënien në Shfrytëzim Afatgjatë Për 99 vite të Pronës së Paluajtshme të Komunës;

Kryesuesi i Kuvendit: Komisioni duhet të jetë me përbërje, 2 anëtarë nga KK, 2 anëtarë nga ekzekutivi, 1 anëtar nga shoqëria civile. E hapi diskutimin: Nëse nuk ka kush diçka, atëherë shkojmë me propozime konkrete;

z. Rustem Zenuni: Në emër të grupit të PDK e propozojmë për anëtar, Selajdin Troni.

z. Agim Mani: Nga LVV e propozojmë për anëtar, Adnan Reka.

z. Qamil Stagova: Nga Ekzekutivi: Gentiana Sallahu dhe Afrim Fuga, ndërkaq nga OJQ Faton Bela.

Kryesuesi i Kuvendit: Propozimet që dolën, i shtroj në votim dhe u aprovuan njëzëri. Prezentë 21. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për Formimin e Komisionit Vlerësues Për Dhënien në Shfrytëzim Afatgjatë Për 99 vite të Pronës së Paluajtshme të Komunës, në përbërje si vijon:

- 1. Gentiana Sallahu** anëtar (ekzekutivi)
- 2. Afrim Fuga** anëtar (ekzekutivi)
- 3. Selajdin Troni** anëtar (PDK)
- 4. Adnan Reka** anëtar (LVV)
- 5. Faton Bela** anëtar (Shoqëria Civile)/Lënda: 01Nr. 400/02-4452/24.

9. Propozim Vendim Paraprak Për Dhënien e Pronës së Paluajtshme të Komunës në Shfrytëzim Afatshkurtër për 15 vite;

Kryesuesi i Kuvendit: Propozim Vendimin e keni marrë, nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Me çfarë takse e rregulloni çështjen e dhënies së pronës komunale në afatshkurtër ?

Kryesuesi i Kuvendit: Me duket se është e caktuar një tarifë fikse fillestare e cila aplikohet, ndërkaq kush e ofron çmimin me të lartë në ankand publik, e merr pronën në shfrytëzim.

z. Agim Mani: Rregullorja e taksave komunale e ka të përcaktuar taksën komunale për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale deri në 1 vit., ndërkaq për 1-15 vjet, nuk ka rregullore.

z. Selajdin Troni: Unë kam qenë pjesë e komisionit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale. Ka qenë një kandidat aplikant që nuk është përzgjedhë, sepse e ka ofruar çmimin minimal të përcaktuar. Nëse është nën çmimin minimal, nuk ka drejtë as me aplikuar.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, e shtroj në votim këtë pikë dhe e njëjta u aprovua me 12 votë Për, Kundër votë nuk ka, Abstenime 7. Prezentë 19. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM PARAPRAK

**Për Dhënien e Pronës së Paluajtshme të Komunës në Shfrytëzim Afatshkurtër për 15 vite/
Lënda: 01Nr. 104/02-4455/24.**

10. Propozim Vendim Për Formimin e Komisionit Vlerësues Për Dhënien në Shfrytëzim Afatshkurtër të Pronës së Paluajtshme të Komunës;

Kryesuesi i Kuvendit: Nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë shkojmë me propozime konkrete, me përfaqësim në këtë komision.

z. Rustem Zenuni: Nga PDK e propozojmë për anëtarë të Komisionit, Brahim Imishti.

z. Agim Mani: Nga LVV e propozojmë, Ernesta Krasniqi.

z. Qamil Stagova: Nga Ekzekutivi: Besmir Krasniqi dhe Sadat Koxha, ndërkaq nga Shoqëria Civile, Emrin Dema.

Kryesuesi i Kuvendit: Propozimet që dolën i shtroj në votim për aprovim, të njëjtat u miratuan njëzëri. Prezentë 19. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për Formimin e Komisionit Vlerësues Për Dhënien në Shfrytëzim Afatshkurtër të Pronës së Paluajtshme të Komunës, në përbërje si vijon:

- | | | |
|----|-------------------------|--|
| 1. | Gentiana Sallahu | anëtar (ekzekutivi) |
| 2. | Afrim Fuga | anëtar (ekzekutivi) |
| 3. | Selajdin Troni | anëtar (PDK) |
| 4. | Adnan Reka | anëtar (LVV) |
| 5. | Faton Bela | anëtar (Shoqëria Civile)/Lënda: 01Nr. 104/02-4453/24. |

11. Plani i Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2024;

Kryesuesi i Kuvendit: Nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë e shtroj në votim planin dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Prezentë 19. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori,

VENDIM

Për Aprovimin e Planit të Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2024/ Lënda: 01Nr. 60/01-2487/24.

12. Kërkesa e MAPL për Rishqyrtimin e Vendimit 01 Nr.06-104/02-1940/24 për miratim në parim të Vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, me pronën e paluajtshme të personit fizik Mejdi (Shabi) Xhokli;

Kryesuesi i Kuvendit: Po e jap një informatë për tri pikët, pastaj vazhdojmë për secilën veç e veç. Këto vendime i kemi miratuar 1 herë, i kemi shfuqizuar, i kemi miratuar për të dytën herë, tani po duhet me i shfuqizuar. Herën e parë na jepet arsye tjetër, herën e dytë tjetër, pse duhet me i shfuqizuar. Ka qenë mirë kur janë kthyer herën e parë, me i potencuar gjitha shkeljet, i kishin përmirësuar. Meqë janë në kohë, atëherë i rishqyrtojmë. Procedurat janë të shkruara që

duhet bëhet vlerësimi i pronës, ajo na merr kohë, pasi që bëhen nga Agjencioni kadastral. E hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Është hera e katërt që shqyrtojmë këto çështje. Në fillimisht kemi qenë kundër procedurave të këtyre pronave. Vazhdimësia e procedurave të këtyre pronave është e çuditshme. Fillimisht janë votuar kështu qysh janë, ndërkaq janë kthyer nga MAPL për me u shpallë fillimisht prona me interes. Në interes publik i keni propozuar pronat private edhe pronat komunale. Është shpallë me interes prona e Mejdi (Azem) Deda, e kam potencuar edhe në KPF, kurse këmbimi bëhet me pronën e Mejdi Xhokli. Krejt anëtarët e kanë votuar, ndërkaq nuk ka reaguar askush. Pse nuk është përmirësuar kjo? Tani është në rregull dhe pajtohem, ndërkaq atëherë nuk jemi pajtuar për çështje procedurale.

Kryesuesi i Kuvendit: Herën e parë është kthyer, se prona fillimisht duhet të shpallet me interes publik, pastaj të merret vendimi për këmbim të pronës, ashtu edhe kemi vepruar. Çështjen e pronave komunale që u potencia se i keni shpallë me interes, është sqaruar me herët se ato prona janë private, por kanë ngelë si prona komunale. Tani kërkohet që prona të vlerësohet, është hera e parë që kërkohet kjo, që komuna fillimisht me shpallë pronën me interes publik, me bërë vlerësimin e pronës, besoj se edhe atyre iu ka ikur ky sqarim në fillim.

z. Rustem Zenuni: Kur janë kthyer vendimet për këmbim, e kam thënë dhe e themi përsëri, se me tepër e shoh njëfarë lloj tendence me i bllokuar këto punë. Tani besoj se kanë me i shikuar edhe me tepër, se kanë arsye me shumë.

z. Agim Mani: Nëse nuk jeni në dijeni, Parcela kadastrale 70917093-00544-0 , sipërfaqja 860.5m2 është në emër të Mejdi (Azem) Deda, në rrugën: “Rmadan Xhokli” ZK Koxhaj.

Kryesuesi i Kuvendit: Vendimi është me ndryshim, vetëm nëse juve ua ka dërguar ashtu.

z. Agim Çaka: Sipas asaj që shihet, ministria nuk është duke kërkuar diçka që është joligjore, çështja është, ata që i kanë dërguar, pse nuk i kanë shikuar mirë këto punë. Adnani që e tha njëfarë trajnimi duhet mbajtur këtu të brendshëm, nuk është me u neglizhuar, se kjo po na merr kohë dhe nuk po kryejmë punë.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, e shtroj në votim këtë pikë dhe e njëjta u miratua njëzëri. Prezentë 21. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për Anulimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës 01Nr. 06-104/02-1940/24 i datës 31.01.2024 për miratimin në parim të Vendimit për Këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, me pronën e paluajtshme të personit fizik Mejdi (Shabi) Xhokli/ Lënda: 01Nr. 104/02-4712/24.

13. Kërkesa e MAPL për Rishqyrtimin e Vendimit 01 Nr.06-104/02-1934/24 për miratim në parim të Vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, me pronën e paluajtshme të personit fizik Adnan (Feriz) Vishi;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë këtë pikë e shtroj në votim dhe e njëjta u miratua njëzëri. Prezentë 21. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës, mori këtë:

VENDIM

Për Anulimin e Vendimit 01 Nr.06-104/02-1934/24 për miratim në parim të Vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, me pronën e paluajtshme të personit fizik Adnan (Feriz) Vishi/ / Lënda: 01Nr. 104/02-4717/24.

14. Kërkesa e MAPL për Rishqyrtimin e Vendimit 01 Nr.06-104/02-1938/24 për miratim në parim të Vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, me pronën e paluajtshme të personit fizik Ramiz (Afiz) Shaqiri;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

z. Adnan Reka: Kur ne e potenconim se këto vendime janë të kundërligjshme, ju na thoni se ne nuk marrim vendime kundërligjore, tani po dalin se vendimet janë kundërligjore. Çështja është se, ne vetëm kemi shpenzuar kohë që sa herë në shqyrtimin e këtyre vendimeve. Edhe të MAPL mund të gabojnë, por kur janë do vendime me rëndësi, janë të kujdesshëm, se mund të përballën me to. Çështja është, pse u ndërtua muri ende pa kaluar vendimi, se duhet me paguar për prishjen e atij muri ? Pse po nxitohet çdo herë kur janë do çështje të cilat nuk janë të qarta, se nuk fund dikush duhet me i bartë pasojat?

Kryesuesi i Kuvendit: Me vendime të tilla përballemi jo vetëm ne por të gjitha komunat.

z. Adnan Reka: Unë po e kritikoj formën, se ne mundemi me marrë vendime të gabuara dhe me i shfuqizuar, por me u nxituar dhe me ndërtuar mure, ajo është diçka përtej kësaj.

Kryesuesi i Kuvendit: Ka pasur raste kur para 10-12 vite është shtruar një rrugë apo trotuar, dhe kemi ardhur në konkludime të tilla për këmbimin e pronës, me arsyetimin se në momentin që një pronë shpallet me interes publik, janë dy forma të kompensimit, me pagesë ose këmbim të pronës. Ne duke u munduar me i ikur formës se pagesës, se vlerësimin e bënë dikush tjetër, niveli qendror, forma me e lehtë për ne është me këmbim. Ligji ka kohë që është në fuqi dhe në bazë të tij ka vite që janë bërë këmbime të pronave. Unë pajtohem për formën, por ligji është në fuqi nga 2010 apo 2012, pse ligji nuk ka vepruar njëjtë edhe para 1-2 viteve. Ne kemi bërë këmbime të pronave, e asnjëherë nuk janë kthyer se prona duhet të vlerësohet fillimisht nga Agjencioni kadastral apo MEF. Kjo është hera e parë që kërkohet, ndërkaq vendimet duhet të trajtohen njësoj, kur ligji është i njëjtë, edhe vlerësimet duhet të jenë të njëjta, se ka pasur çështje që para 2-3 muajve ka kaluar. Tani kërkohet kjo formë dhe duhet të veprojmë sipas saj.

z. Adnan Reka: Para juve kryesues ka qenë një kryesues tjetër, ka punuar me të njëjtën rregullore, tani ju jeni kryesues tjetër dhe punon me të njëjtën rregullore, por mënyrën e punës e ke ndryshe. Ndoshta ju e shikoni rregulloren me mirë dhe mbi bazën e kësaj ne ecim përpara dhe kjo quhet progres, e jo nëse ka ndodhë një gabim dhe mbi atë bazë veprojmë njëjtë çdoherë. Mendoj se kjo mënyrë është pozitive. E pyes drejtorin, pse u nxituat me ndërtua murin, pa përfunduar lënda? Nëse keni bërë marrëveshje na e sjelli që ta dimë? Desha me iu pyetur: A arritët me i dërguar projektet në ministri, se afati përfundon sot?

z. Qamil Stagova: Çështja është se ne si komunë ia kemi prishur murin dhe ia kemi ndërtuar murin.

Kryetari i Komunës: Tani vjen zyrtari dhe i sjellë të gjitha projektet që janë dërguar, se janë dërguar me protokoll. Këto projekte janë dërguar në çdo shtator në ministrinë e linjës, por nuk kemi marrë përgjigje.

znj. Kadrije Lika-Troni: Ju nuk e keni ditur që ka afat edhe sot për dërgim të projekteve, Adnani ju tregoj.

Kryetari i Komunës: Ne Kadrije e kemi dërguar dje një projekt, ndërsa sot janë dërguar 6 projekte.

z. Adnan Reka: Shpresoj t'i keni dërguar të kompletuara projektet.

Kryesuesi i Kuvendit: E bërë krahasimin e kryesuesit të mëhershëm dhe tani. Unë po flas për tani, që me herët të njëjtat vendime janë kthyer pozitiv, ndërkaq tani negativ. Në rregull, pajtohem nëse kanë filluar nga tani me punuar me mirë.

z. Rustem Zenuni: Unë kërkoja edhe me herët që kërkesat që dërgohen në ministri, na i dërgoni edhe neve në email,

z. Adnan Reka: Edhe arsyetimet e ministrisë me na i dërguar që t'i shohim.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, e shtroj në votim këtë pikë dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Prezentë 21. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për Anulimin e Vendimit 01 Nr.06-104/02-1938/24 për miratim në parim të Vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, me pronën e paluajtshme të personit fizik Ramiz (Afiz) Shaqiri/ Lënda: 01Nr. 104/02-4722/24.

15. Diskutim për Planit Zhvillimor Komunal-PZHK.

z. Agim Mani: Ne edhe fillimisht kryesues nuk u pajtuam për këtë pikë, se nuk kemi si të diskutojmë pa pasur material.

z. Qamil Stagova: Unë ju kisha bërë thirrje Adnan që projektet që janë në interes të komunës, mos me i penguar.

z. Selajdin Troni: Subjekti politik i LDK e ka kërkuar me diskutuar këtë pikë, ndërkaq anëtarët e vet nuk i ka të gjithë këtu, kjo nuk është në rregull.

